REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**
**KRYETAR**

Nr. 12140 prot. Shkodër, më 17.6. 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi **"Për një shtese dhe ndryshim në VKB nr. 76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025- 2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar"**

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: **"Për një shtese dhe ndryshim në VKB nr. 76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025- 2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar"**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**
**KRYETAR**

Nr. _____prot. Shkodër, më ___.___. 2025

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.______, datë____.____.2025**

**"PËR NJË SHTESE DHE NDRYSHIM NË VKB NR. 76 DATË 19.12.2024 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR " I NDRYSHUAR**

Këshilli i bashkisë Shkodër, sot në datë _________.2025, në mbështetje të neneve 40, 41, 54 germa 'dh', të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ,të nenit 45 te ligjit nr.68/2017`` Për financat vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar,", Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar ; Udhëzimit Plotësues i Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 "Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2025", "VKB nr. 76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër" , i ndryshuar, dhe sipas materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shteses në buxhetin e vitit 2025 sipas tabelës 1, bashkëlidhur.
2. Miratimin e rishpërndarjes ndërmjet programeve, të fondeve të trashëguara, sipas pakësimeve dhe shtesave sipas tabelës 2 dhe 3 bashkëlidhur si dhe fish projekteve perkatese bashkelidhur per shtesat e fondeve referuar tabeles 3 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, ëeb: ëëë.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

*Zv. Kryetar*

*Zv. Kryetar*

*Drejtoria e Pergjithshme e MF*

*Drejtoria e të Ardhurave*

*Drejtoria e Pergjith Kulturës dhe Sportit*

*Drejtoria e Arsimit*

*Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike*

*NA* _______________

*NZ* _______________

*IMT*

*Zv. Kryetar*

*Drejtoria Pergjith.Juridike,BNJ dhe Sherbimeve mbeshtetese*

*Drejt e Pergjith. e Zhvillimit Qendrueshem ekonomik*

*Ndermarrja e Shërbimeve dhe puneve Publike,*

*NA* _______________

*NZ* _______________

*Drejtoria e Pergjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Rinise*

*Drejtoria e Emergjencave Civile*

*Policia Bashkiake*

Drejtoria e Aseteve

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Sportit

Drejtoria e Kultures,

Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese

Drejtoria e Mjedisit dhe energjise se rinovueshme

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit te AMTP

Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit te territorit

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Terrritorit

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Drejtoria e Turizmit

Drejtoria e Administrimit te Sistemeve Menaxhimit te Z1N,Projekteve dhe Menaxhimit te Sistemeve te Informacionit

Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

NA ____________________

NZ ____________________

*TABELA 1*

**<u>Shtesë plani në buxhetin e vitit 2025 për tejkalimin e të ardhurave në buxhetin e vitit 2024</u>**

*Në lekë*

| Institucioni | Emërtimi i Aktivitetit | Projekte | Investime | Totali 2025 |
|---|---|---|---|---|
| Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike | P.AE141.Q2.O1.A4<br>A Lujmë Bashkë? | | 9,327,288 | 9,327,288 |
| Drejtoria e Përgjithshme Mirëmbajtjes së Objekteve Publike | P.AI141.Q1.O3 .A3<br>Rikonstruksion i kopshtit Bep Tusha | 1,933,385 | 56,751,969 | 58,685,354 |
| | **TOTALI** | **1,933,385** | **66,079,257** | **68,012,642** |

**K R Y E T A R**

**BENET BECI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

# DETAJIM I RISHPËRNDARJES FONDE TË TRASHËGUARA

## Pakësim Viti 2024

***TABELA 2***

**Përmbledhëse ( Transfertë e pakushtëzuar, Transfertë e pakushtëzuar sektoriale & Të ardhura)**

Në lekë

| Prog. | Emërtimi Programit | Llog. Ek. | Bashkia Qendër | Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit | Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike | Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike | Totali Pakësimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AA141 | Manaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse | 602 | 32,756 | - | - | - | 32,756 |
| AB141 | Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile | 602 | 429,506 | 10,415 | - | - | 439,921 |
| AD141 | Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi | 602 | 17,530,630 | - | - | - | 17,530,630 |
| AE141 | Shërbimet Publike Vendore | 602 | - | - | 98,984,681 | - | 98,984,681 |
| AE141 | Shërbimet Publike Vendore | 606 | - | - | 21,412 | - | 21,412 |
| AF141 | Kultura, Sporti, Argëtimi | 602 | 49,000 | - | - | 12,758,875 | 12,807,875 |
| AF141 | Kultura, Sporti, Argëtimi | 604 | 35,000 | - | - | - | 35,000 |
| AF141 | Kultura, Sporti, Argëtimi | 605 | 24,301 | - | - | - | 24,301 |
| AG141 | Përkujdesi Social | 602 | 114,760 | - | - | 4,661,560 | 4,776,320 |
| AG141 | Përkujdesi Social | 606 | 47,680 | - | - | - | 47,680 |
| AI141 | Arsimi | 602 | 158,782 | - | - | 25,937,673 | 26,096,455 |
| | **TOTALI SHPENZIME DHE TRANSFERIME** | | **18,422,415** | **10,415** | **99,006,093** | **43,358,108** | **160,797,031** |
| AA141 | Manaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse | 231 | 2,581,320 | - | - | 9,906,465 | 12,487,785 |
| AB141 | Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile | 231 | 54,584 | - | - | - | 54,584 |
| AC141 | Mbështetja për zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural | 231 | 390,604 | - | - | - | 390,604 |
| AD141 | Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi | 230 | 5,758,535 | - | - | - | 5,758,535 |
| AD141 | Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi | 231 | 25,337,827 | - | - | - | 25,337,827 |
| AE141 | Shërbimet Publike Vendore | 231 | - | - | 3,959,707 | - | 3,959,707 |
| AF141 | Kultura, Sporti, Argëtimi | 231 | 4,736,155 | - | - | 1,494,147 | 6,230,302 |
| AG141 | Përkujdesi Social | 231 | - | - | - | 6,969,000 | 6,969,000 |
| AI141 | Arsimi | 230 | - | - | - | 1,235,551 | 1,235,551 |
| AI141 | Arsimi | 231 | 570,354 | - | - | 14,731,194 | 15,301,548 |
| | **TOTALI SHPENZIME KAPITALE** | | **39,429,379** | **-** | **3,959,707** | **34,336,357** | **77,725,443** |
| | **TOTALI** | | **57,851,794** | **10,415** | **102,965,800** | **77,694,465** | **238,522,474** |

**K R Y E T A R**

**BENET BECI**

**Shtesa viti 2025**

***TABELA 3***

*Në lekë*

| Institucioni | Programi | Emërtimi i Aktivitetit | Detajim Viti 2025 | | | | | | | Detajim Viti 2026 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Projekte | Investime | Totali 2025 | Investime | Totali 2026 |
| Bashkia Shkodër | AA141 | P.AA141.Q1.O1.A1. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe honorare për kryetarët e fshatrave (shtesë) | 2,038,523 | 324,215 | | | | | 2,362,738 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q1.O1.A3 Anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (shtesë) | | | | 1,630,200 | | | 1,630,200 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q3.O2.A1. Detyrime dhe kompensime legale (shtesë) | | | 340,094 | | | | 340,094 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q3.O4.A1 . Paga per drejtorine e te ardhurave, pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore dhe shpenzime korente dhe kapitale (shtesë) | 1,302,788 | 207,200 | | | | | 1,509,988 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q3.O5.A4 Blerje Licenca Software | | | | | 5,000,000 | | 5,000,000 | | |
| | AB141 | P.AB141.Q2.O1.A6 Reduktimi i pasojave të përmbytjes | | | | | | 12,414,478 | 12,414,478 | | |
| | AC141 | P.AC141.Q4.O1.A3. Ndërtimi i Zyrës së re InfoPoint | | | | | 398,000 | 8,176,000 | 8,574,000 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A1 Paga dhe sigurime te personelit te Teatrit "Migjeni" dhe Kinema Republika (shtesë) | 329,438 | 52,395 | | | | | 381,833 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A15. Realizimi i Aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kulturës (shtesë) | | | | 4,100,000 | | 3,400,000 | 7,500,000 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete në partneritet me të tretë (shtesë) | | | | 6,000,000 | | | 6,000,000 | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | AI141 | P.AI141.Q1.O1.A1.<br>Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor ( paga/sigurime shoqerore ) (shtesë) | 915,810 | 145,655 | | | | | 1,061,465 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O1.A2.<br>Mbështetja e personelit mbështetës për arsimin bazë. (paga/sigurime shoqërore) dhe stafi i drejtorisë ( shtesë) | 901,740 | 143,415 | | | | | 1,045,155 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q3.O1.A1<br>Mbështetja e personelit të çerdheve (Paga dhe sigurime shoqërore) (shtesë) | 976,448 | 155,300 | | | | | 1,131,748 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q1.O2.A2<br>Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit "28 Nëntori", Shkodër | | | | | | 2,817,949 | 2,817,949 | 1,675,458 | 1,675,458 |
| | AF14 | P.AF141.Q1.O2.A3<br>Ndërtim i ambienteve Sportive të Shkollës "Tring Smajli" | | | | | | 9,175,594 | 9,175,594 | 5,337,681 | 5,337,681 |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli" | | | | | | 7,612,037 | 7,612,037 | 4,599,624 | 4,599,624 |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3.A8.<br>Rikonstruksion dhe ndërtim palestre "Shkolla e hapur "Ismail Qemali" | | | | | | 46,851,531 | 46,851,531 | 29,980,622 | 29,980,622 |
| Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike | AE141 | P.AE141.Q1.O1.A4<br>Mirëmbajtje, rehabilitim i skemës ujitëse (Shtesë) | | | 27,850,000 | | | | 27,850,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q1.O1.A5<br>Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma | 2,909,000 | 463,000 | | | | | 3,372,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q1.O1. A3<br>Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (Shtesë) | | | | | | 7,100,000 | 7,100,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q2.O1.A4<br>A Lujmë Bashkë? | | | | | 1,519,000 | 21,427,712 | 22,946,712 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q3.O1.A3<br>Lëvizshmëria dhe sinjalistika (Shtesë) | | | 300,000 | | | 4,300,000 | 4,600,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q4.O2.A2<br>Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane (Shtesë) | | | | | | 19,000,000 | 19,000,000 | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | AE141 | P.AE141.Q7.O1.A5<br>Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit (Shtesë) | | | | | | 8,000,000 | 8,000,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q7.O1.A6:<br>Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Njësive Administrative (Shtesë) | | | 9,800,000 | | | | 9,800,000 | | |
| Drejtoria e Përgjithshme Mirëmbajtjes së Objekteve Publike | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A1/1<br>Paga dhe sigurime shoqërore për stafin për punonjësit mbështetës te Kinema Republika | 837,900 | 133,266 | | | | | 971,166 | | |
| | AG141 | P.AG141.Q1.O1.A2<br>Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor | 837,900 | 133,266 | | | | | 971,166 | | |
| | AG141 | P.AG141.Q2.O1.A1/1<br>Paga dhe Sigurime per ofrimin e kujdesit shoqeror per familjet dhe femijet (Qendra Komunitare) | 433,650 | 68,971 | | | | | 502,621 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3 .A9<br>Rikonstruksion Shkolla Salo Halili | | | | | 6,000,000 | | 6,000,000 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3 .A10<br>Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi | | | | | 6,000,000 | | 6,000,000 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A23<br>Rikonstruksion Biblioteka Marin Barleti | | | | | 6,000,000 | | 6,000,000 | | |
| | | **TOTALI** | **11,483,196** | **1,826,683** | **38,290,094** | **11,730,200** | **24,917,000** | **150,275,301** | **238,522,474** | **41,593,385** | **41,593,385** |

**K R Y E T A R**

**BENET BECI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**
**KRYETAR**

Nr._____ Prot

Shkodër, më ____.____.2025

# RELACION

**"Për një shtese dhe ndryshim në VKB nr. 76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025 - 2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar"**

## KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar ; të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të ndryshuar ; Udhëzimit Plotësues i Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 "Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2025" Bashkia paraqet disa ndryshime në buxhetin e saj te miratuar me "VKB nr. 76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër" , i ndryshuar,ku përfshihen shtesa, pakësime dhe rialokime të fondeve të trashëguara nga viti 2024.

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2024 realizoi të ardhurat e veta në masën 107.1 % me një realizim nga të ardhurat e veta me shume në vleren 68 012 mijë lekë e ndarë si më poshtë:

*Ne mije leke*

| **TE HYRAT DHE FINANCIMET NE LLOGARITE E THESARIT** | **Plani 2024** | **Realizimi 2024** | **Diferenca** |
|---|---|---|---|
| **TE ARDHURAT E VETA** | **954,000** | **1,022,012** | 68,012 |
| Të ardhura nga taksat vendore | 376,487 | 425,749 | 49,262 |
| Të ardhura nga taksat e ndara | 152,163 | 176,374 | 24,211 |
| Te ardhura nga tarifat vendore | 391,990 | 374,073 | - 17,917 |
| Të ardhura të tjera | 33,360 | 45,816 | 12,456 |

Zërat kryesorë, që janë me tejkalim në krahasim me planin e vitit 2024 janë: të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat për biznesin, të ardhurat nga taksa e truallit, të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel, taksa e ndikimit

në infrastrukturë, të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura, të ardhura nga tarifa e parkimit të mjeteve të liçensuara dhe parkimeve të rezervuara, tarifa për zënien e hapësirës publike, taksa e tabelës si dhe të ardhurat nga kundravajtjet administrative që vijnë si rezultat i mbledhjes së detyrimeve aktuale po ashtu edhe atyre të prapambetura nëpërmjet bllokimit të llogarive të biznesit apo akt-marrëveshjeve për pagesë me këste.

Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkalim si rezultat i zgjerimit të bazës së taksapaguesve si efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe konkretisht realizimit të **4885 akt-kontrolleve**, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore me rreth **841** bllokime llogari bankare biznes dhe **1270** bllokime llogari bankare individ, **413** Urdhër Ekzekutime dhe **234** akt-marrëveshje për detyrimet e prapambetura. Gjithashtu sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i taksapaguesve nëpërmjet njoftimeve në media dhe në ëeb, nëpërmjet dërgimit të rreth **5054** njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyrën me 1-Ndalesë, rivlerësimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatmorë etj.

Prandaj **shtesa e buxhetit 2025 si rrjedhojë e realizimit të të ardhurave të veta me teper se planifikimi është në shumën 68 012 642 leke detajuar sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur projekt- vendimi.**

Rishpërndarje në fondet e veta transfertë e pakushtezuar e pergjithshme , sektoriale dhe të ardhura të veta, në **shumën 238 522 474 lekë, teprica nga viti i kaluar**, do të bëhet sipas kërkesave buxhetore të paraqitura nga drejtuesit e programeve, të dakordësuara nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe të bashkëlidhura me këtë relacion.

**Administrata e Bashkise Shkoder**

1. **Programi AA/AF/AI 141**

Bashkia Shkodër konform përmbushjes së detyrimeve, sipas përcaktimeve ligjore të parashikura në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, gjithashtu sipas parashikimeve të Buxhetit të vitit 2025 sipas VKB nr.76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar, në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar pagesa për Aparati i Bashkisë i cili ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës. Në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, për vitin 2025 do të vijojë realizimi në vazhdimësi i menaxhimit efektiv dhe shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve si dhe shpërblimi i honorareve të kryetarëve të fshatit të Njësive Administrative në territorin e Bashkisë Shkodër , në përputhje me aktet ligjore ne fuqi.
Duke vlerësuar rritjen e vazhdueshme të ngarkesës së punës dhe përgjegjësitë të aparatit, vlerësojmë se burimet njerëzore aktuale nuk mjaftojnë për të garantuar realizimin me cilësi, në kohë dhe në përputhje me kërkesat ligjore të detyrave të ngarkuara. Proceset e punës dhe procedurat në tërësi kërkojnë angazhim të detajuar, korrektësi në dokumentacion e hartuar, ndjekje administrative teknike, si dhe komunikim të vazhdueshëm si brenda dhe jashtë institucionit. Në këto kushte, kërkohet shtimi i stafit për të garantuar respektimin e ligjit, përmirësimin e performancës dhe shmangien e vonesave apo gabimeve që mund të kenë pasoja financiare apo ligjore për institucionin si më poshte:

a) Në Programin AA141, produkti V111AAA, Aktiviteti P.AA141.Q1.O1.A1 *Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së*

*misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe honorare për kryetarët e fshatrave, (shtesë)*, shtohen 3 punonjes me efekt financiar: Paga në vleren 2,038,523 lekë dhe Sigurime Shoqërore në vleren 324,215 lekë.

b) Në Programin AA141, produkti V112AAB, Aktiviteti P.AA141.Q3.O4.A1, *Paga per drejtorine e te ardhurave ,pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore dhe shpenzime korente dhe kapitale (shtesë* ) shtohen 2 punonjës me efekt financiar : Paga në vleren 1,302,788 lekë dhe Sigurime Shoqërore në vleren 207,200 lekë.

c) Në Programin AF141, produkti V823AAA, Aktiviteti P.AF141.Q2.O3.A1 *Paga dhe sigurime te personelit te Teatrit "Migjeni" dhe Kinema Republika (shtesë)* shtohet 1 punonjës me efekt financiar : Paga në vleren 329,438 lekë dhe Sigurime Shoqërore në vleren 52,395 lekë

*d)* Në Programin AI141, produkti V912AAA, *P.AI141.Q1.O1 .A2. Mbështetja e personelit mbeshtetes për arsimin bazë. (paga/sigurime shoqerore) dhe stafi i drejtorise (shtesë)* shtohet 2 punonjës me efekt financiar : Paga në vleren 901,740 lekë dhe Sigurime Shoqërore në vleren 143,415 lekë.

e) Në Programin AI141, produkti V043AAC, P.AI141.Q3.O1.A1 *Mbështetja e personelit te cerdheve ( paga/sigurime shoqerore (shtesë)* shtohet 1 punonjës me efekt financiar : Paga në vleren 976,448 lekë dhe Sigurime Shoqërore në vleren 155,300 lekë.

f) Në Programin AI141, produkti V912AAA, P.AI141.Q1.O1 .A1. *Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor (paga/sigurime shoqerore) (shtesë)* shtohen 2 punonjës me efekt financiar : Paga në vleren 915,810 lekë dhe Sigurime Shoqërore në vleren 145,655 lekë.

## 2. Programi AA 141 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse

1. Bashkia Shkodër konform përmbushjes së detyrimeve, sipas përcaktimeve ligjore të parashikura në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, gjithashtu sipas parashikimeve të Buxhetit të vitit 2025 sipas VKB nr.76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar, në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar pagesa për kuotën e anëtarësisë në Shoqatën për autonominë vendore në vleren 500,000 lekë
Me vendimin Nr.5 datë 20.12.2024, të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës për Autonominë Vendore, u bë ndryshimi i emrit nga "Shoqata për Autonominë Vendore" në "Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë" , ndryshimi i Logos dhe Selisë së Shoqatës,shfuqizimi i Statutit dhe rregullores së vjetër të Shoqatës, miratimi i dhe hyrja në fuqi i Statutit dhe Rregullores së re. Në këtë Shoqatë aderon edhe Bashkia Shkodër
Me shkresen nr.476.prot, të "Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë", drejtuar Bashkisë Shkodër, kërkohet pagesa e kuotës së anëtarësisë në këtë Shoqatë në vleren 2,130,200 lekë për vitin 2025 bazuar në nenin 7, pika b) dhe nenit 11 pika k) të "Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë"
Duke qenë se në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar pagesa për kuotën e anëtarësisë në Shoqatën për autonominë vendore në vleren e 500,000 lekë, kërkohet shtesë fondi **në vlerën 1,630,200 lekë sipas fishes bashkelidhe PAA141.Q1.O1.A3-Anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (Shtesë ).**

2. Në programin, AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse kërkojmë të krijohet një aktivitet i ri PAA141.Q3.O5.A4, Blerje Licenca Software. Krijimi i kësaj fishe kërkohet që të përdoret për të blerë licencën për paketën e Microsoft Office. Kjo blerjë do të sigurojë një version të plotë, të sigurtë dhe të përditësuar të aplikacioneve të përfshira si Word, Excel, PowerPoint dhe Outlook, të cilat janë thelbësore për mbarëvajtjen e punës. Blerja e kësaj licence zyrtare do të sigurojë qasje në të gjitha funksionalitetet profesionale, ruajte në cloud përmes OneDrive, dhe mbështetje teknike nga Microsoft. Për më tepër, përdorimi i një versioni të licencuar garanton respektimin e ligjit për të drejtën e autorit dhe shmang rreziqet që vijnë nga versione të paligjshme, të cilat shpesh përmbajne viruse apo mangësi në funksionalitet. Gjithashtu, përdorimi i kompjuterave me një paketë Office të licencuar dhe të përditësuar siguron pajuteshmërinë dhe konsistencën në editimin dhe përpunimin në filë të shpërndarë brenda institucionit.
   Blerja e Antivirusit është një hap thelbësor për të mbrojtur të dhënat, dokumentat e rëndësishme dhe vetë mbrojtjen e pajisjeve nga kërcënimet digjitale dhe sulmet kibernetike. Një Antivirus i licencuar ofron mbrojtje në kohë reale, përditësime të rregullta kundër rreziqeve të reja dhe funksione shtesë si fireëall apo dhe mbrojtje gjatë përdorimit të internetit dhe kontroll të e-maileve. Ndër të tjera, kjo blerje bazohet edhe në rekomandimin nr. 06, në Raportin Final të Auditimit me nr. 16829/3, dt., 14.10.2024. Shume e kerkuar eshte **5 000 000 leke sipas fishes bashkelidhe PAA141.Q3.O5.A4 Blerje Licenca Software A.1 Blerje Licenca MS Office + Antivirus**

3. Ne programin AD141– Planifikim dhe kontrolli i territorit dhe Mjedisit ne aktivitetin P06260.Q3.O1.A6: Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik te Njësive Administrative -te trasheguara eshte obligim ne Dege te thesarit shuma 340 094 leke ne artikullin 602 . Kerkohet qe kjo shume te kalohet ne programin AA 141 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse ne aktivitetin P.AA141.Q3.O2.A1. Detyrime dhe kompensime legale (shtesë). Pra kerkohet transferim vetem ndermjet programeve duke ruajtur destinacionin.

4. **Programi AB141 - Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile**

**Bashkia Shkodër me Projektin: "Reduktimi i pasojave të përmbytjes"** është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile (AKMC), në vijim të aplikimit nr. 27044 datë 25.11.2024 "Dërgim i projekt propozimeve për aplikim në kuadër të programit "Emergjencat Civile" Viti 2025 sipas Vendimit nr. 127 datë 28.2.2025 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore".

Bashkia Shkodër, ka në inventarin e saj kanale kulluese të njësive administrative. Gjithsej janë 729,8 km nga të cilët 129,8 km kanale të dyta dhe 600 km kanale të treta kulluese. Në pjesën më të madhe të këtij inventari gjendja ka qenë jo funksionale për mungesë të mirëmbajtjes dhe pastrimit ndër vite. Përgjatë këtyre viteve ka pasur investime dhe ndërhyrje të vazhdueshme në rrjetin e këtyre kanaleve duke përmirësuar ndjeshëm situatën e kullimit.

Gjithashtu sa i përket kolektorit kryesor të shkarkimit të ujrave të bardha të qytetit, një pjese e ketij kolektori është zënë nga ndërtimet e ndryshme të cilat tashmë kanë edhe lejet përkatëse (Legalizim etj.), duke vështirësuar menaxhimin, kontrollin dhe pastrimi i tij. Bashkia Shkodër gjatë kësaj periudhe është angazhuar maksimalisht përmes ndërmarrjes së shërbimeve publike në pastrimin e kolektorit kryesor të

qytetit i cili ka një gjatësi prej 2.1 km. Një pjesë tjetër e këtij kolektori është i bllokuar totalisht ndërsa në segmentet ku është pastruar është emergjente ndërtimi i skarpatave të kanalit në mënyrë që të eleminohet risku i erozionit të tokës përreth.

Ndërtimi i skarpatave dhe tombinove të kolektorit kryesor të qytetit do të ndikojë direkt në parandalimin e përmbytjes së qytetit duke përmirësuar sistemin e shkarkimit të ujrave të bardha përgjatë rreshjeve të cilat në Shkodër kanë një intensitet të lartë. Gjithashtu këto punime do të ndikojnë mbrojtjen e tokave dhe banesave përreth kolektorit duke eleminuar rrezikun e shëmbjeve.

Përmes këtij projekti parashikohet vendosja e tombinove 5x5 dhe tombinove 3x3 do të ndikojnë direkt në ndërtimin e nje rrjeti përfundimtar të shkarkimit të ujrave i cili është totalisht i amortizuar, megjithë përpjekjet e Bashkisë Shkodër për pastrim të tij është e nevojshme një ndërhyrje totale për të eleminuar problematikën e përmbytjes në rrugët e qytetit. Projekti parashikon të bëjë ndërhyrje përgjatë kolektorit kryesor të shkarkimit të ujrave të bardha dhe në të gjithë rrjetin e kanaleve kulluese.

Gjithashtu do të bëhen ndërhyrje sa i përket ndërtimit të nyjeve tombino dhe urave në kanalet e dyta e të treta në njësitë administrative ku përveç parandalimit të përmbytjeve në zonat e banuara dhe bujqësore, ndihmojnë edhe ruajtjen e tokave nga lagështia e tepruar duke siguruar kushte më të mira për kultivimin e bimëve apo rritjen e rendimentit të kulturave duke sjellur ekonomi më të mirë për fermerët.

Investimi i propozuar për realizimin e kësaj ndërhyrjeje për Reduktimi i pasojave të përmbytjes sipas preventivave parashikohet të jetë në vlerë totale 64,612,685 lek me tvsh. AKMC do të financojë për Bashkinë Shkodër Vlerën prej 52,198,207 Lekë. Bashkia Shkodër do të mbulojë fondin prej **12,414,478** për supervizimin, kolaudimin dhe TVSH, sipas fishës bashkëlidhur.

**Sa më siper referuar bazes ligjore:** në mbështetje të nenit 23 pika 3; neni 54 germa 'dh' të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", i ndryshuar; Ligj Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile; Vendimit nr. 127 datë 28.02.2025 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025", VKB nr.76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës", i ndryshuar, Shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nr. 10779 datë 29.05.2025 "Mbi aplikimin në programin Emergjencat Civile 2025".;
Në vijim të aplikimit nr. 27044 datë 25.11.2024 "Dërgim i projekt propozimeve për aplikim në kuadër të programit "Emergjencat Civile" Viti 2025 kerkohet :

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin "Reduktimi i pasojave të përmbytjes". Projekti financohet nga AKMC (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) nën thirrjen e shpallur nga Ministria e Mbrojtjes për programin "Emergjencat Civile" viti 2025, për zbatimin, të investimit në vlerën 52,198,207 leke, në zërin investime, prej të cilave 10,439,641 lekë për vitin 2025 dhe 41,758,566 lekë për vitin 2026, sipas shkreses 10779 prot. datë 29.05.2025 të AKMC "Mbi aplikimin në Programin Emergjencat Civile 2025" grant nga AKMC, sipas Vendimit nr. 127 datë 28.2.2025 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore", sipas fishës bashkëlidhur.

2. Miratimin e fondit të bashkëfinancimit të projektit për vlerën e TVSH, Supervizim dhe Kolaudim të projektit "Reduktimi i pasojave të përmbytjes" për vitin 2025, në programin Siguria Publike dhe Mbrojtja civile sipas fishës bashkëlidhur **P.AB141.Q2.O1.A6 Reduktimi i pasojave të përmbytjes në vlerën prej 12,414,478 lek.**

## 5. Programi AC 141 - Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural

Në situatën aktuale të zhvillimit intensiv të turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër, është vënë re një rritje e vazhdueshme e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët vizitojnë atraksione të ndryshme në qytet, në zonat përreth, si dhe në destinacione të njohura si Velipoja dhe Thethi. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre turistëve udhëtojnë në mënyrë të pavarur (self-guided), pa ndihmën e agjencive turistike dhe pa informacion të strukturuar mbi destinacionin.

Në këtë kontekst, **informacioni turistik** bëhet një komponent kyç për një përvojë pozitive turistike. Ai u shërben vizitorëve për:

- orientim në qytet dhe rrethina,
- njohjen me pikat turistike, kulturore dhe natyrore,
- informim mbi oraret e funksionimit të atraksioneve,
- akses në shërbimet publike dhe transportin lokal,
- rekomandime për aktivitete dhe eksperienca lokale.

Aktualisht, Bashkia Shkodër disponon **dy zyra të informacionit turistik**, njëra e vendosur në qytetin e Shkodrës dhe tjetra në zonën e plazhit të Velipojës, ndërsa ofrohet shërbim edhe për zonën e Thethit nëpërmjet stafit të dedikuar. Megjithatë, zyra aktuale në qytet **nuk përmbush më kërkesat e kohës**, as në aspektin funksional, e as në pamjen vizuale apo kapacitetin për të ofruar një përvojë moderne dhe ndërvepruese për turistët.

Propozohet **investimi për ndërtimin dhe arredimin e një Zyre të Re të Informacionit Turistik**, e cila do të:

- jetë e vendosur në një **lokacion strategjik** në hyrje të zonës muzeale dhe pranë pikave të transportit,
- ketë **pamje bashkëkohore dhe atraktive**, duke funksionuar si një pikë mikpritjeje për vizitorët,
- përfaqësojë vizualisht dhe nëpërmjet materialeve të dizajnuara me kujdes **gjithë territorin e Bashkisë Shkodër,**
- jetë e pajisur me teknologji dhe materiale të nevojshme për komunikim efikas: harta interaktive, ekranë informues, materiale promocionale, QR code me guida digjitale, etj.

**Efektet e pritshme:**

- Rritje e përvojës pozitive të vizitorëve;
- Informim më i mirë për shërbimet dhe produktet lokale;
- Promovim më efikas i vlerave kulturore, natyrore dhe historike të Shkodrës;
- Krijimi i një imazhi modern dhe miqësor për turistët që hyjnë në qytet.

Sa më sipër kerkohet miratimin e shtesës se planit në Programin AC141 "Mbështetja për zhvillim ekonomik" në zerin Shpenzime kapitale sipas **fishës P.AC141.Q4.O1.A3. "Ndërtimi i Zyrës së re InfoPoint" bashkëlidhur ne shumen 8 574 000 leke .**

6. **AF 141- Kultura, Sporti , Argëtim**

***P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete në partneritet me të tretë (shtesë)***

Bashkia Shkoder ofron mundesine iniciativave te reja per te sjelle propozime ne lidhje me fusha te ndryshme te artit si muzika, artet vizuale, instalacione, arti skenik, prodhime te reja audio-vizuale kinematografike apo skenike. Gjate vitit janë bere disa thirrje per aplikime të hapura te cilat u shqyrtuan nga keshilli artistik ne perputhje me politikat e drejtorise se kultures. Keshilli artistik ne tre mbledhjet e realizuara deri tani , ka miratuar projektet: "Festivali i muzikes moderne" , "7 Minuta", "Zbulo rrënjët e tua" , " Mirush Kabashi", "Moto Fest ", "Festivali gegnisht" , 'Njerzorja hyjnore" , "Shkodra Art Rezidence", "Idromeno kostumografi". Pasi behen thirrjet për aplikime, organizohen mesatarisht cdo 2(dy) muaj mbledhjet e Keshillit Artistik . Aplikimet jane totalisht te hapura per evente dhe aktivitete nga me te ndryshmet artistike. Ne keto 3(tre) mbledhje te keshillit artistik aplikimet e projekteve kane qene te shumta dhe te nje niveli te larte. Per te krijuar hapesira per projektet te tjera deri ne fund te vitit , kerkojme te shtojme **fond ne shumen 6,000,000 lekë.**

***P.AF141.Q2.O3.A15 Realizimi I aktiviteteve te realizuara nga Drejtoria e Kultures***(shtesë)

***A.5. Shkodra n'fest*** është projekt i cili do ti dedikohet aktiviteve që do të organizohen në pika të ndryshme të qytetit në kuadër të festave të fundvitit. Ky projekt ka për qëllim organizimin e koncerteve të cilat përfshinë artistët shkodranë, grupet rinore, profesionistë, të ftuar special dhe një hapsirë e veçantë do ti dedikohet tërësisht aktiviteteve për fëmijë. Përgjatë gjithë muajit dhjetor, cdo ditë para sheshit të bashkisë Shkodër u realizuan performanca nga të gjitha kopshtet e shkollat e territorit të Bashkisë Shkodër, duke sjelle gjalleri dhe entuziazem si tek femijët por edhe tek te rrituri. Nga eksperienca e viteve te kaluar ka rezultuar nje aktivitet shumë i suksesshem , me koncerte dhe aktivitete nga data 1 deri me date 31 Dhjetor. Per te rritur standartin e aktiviteteve dhe nivelin e artisteve te ftuar, shqiptar dhe te huaj , **kerkojme nje fond shtese prej 4,100,000 leke per realizimin e aktiviteteve dhe 3,400,000 leke per blerjen e 20 shtëpizave per organizimin e "Christmas market".**

7. **AI141 - Arsimi**

Bashkia Shkodër në kuadër të thirrjes për projekte nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ka aplikuar me shkresën nr. 5501 datë 07/03/2025 "Dërgim i dosjeve të aplikimeve për projekte, në kuadër të Thirrjes së I për financim të Programeve „Arsimi Bazë", „Arsimi i mesëm" dhe programi „Për zhvillimin e sportit"". Përmes shkresës nr. 2174/1 datë 09.04.2025 "Njoftim për shpallje fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", për objekte shkollore të arsimit para universitar dhe programit për sportin" Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projekt propozimeve të paraqitura sipas programeve, përkatësisht:

1. **Arsimi Bazë: Rikonstruksion dhe ndertim palestre "Shkolla e hapur "Ismail Qemali"**

Qëllimi i projektit Shkolla e hapur "Ismail Qemali" është:

a) Ndërhyrje të sistemeve të sinjalistikës dhe Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ) për të krijuar një sistem funksional dhe të sigurt.
b) Ndërhyrje do të ketë edhe në rrjetet elektrike duke realizuar rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm të ndricimit. Rrjeti hidraulik gjithashtu do të ketë instalime të reja. krijimin e një hapësire funksionale dhe tërheqëse, që jo vetëm përmirëson mjedisin arsimor, por edhe kontribuon në forcimin e lidhjeve sociale dhe komunitare.
c) Krijimi i klasave moderne dhe fleksibile që mund të përshtaten për metoda mësimdhënieje të ndryshme (grupore, individi, aktivitete praktike, etj.).
d) Sigurimi i kushteve për mësim të përshtatshëm, me hapësira të ajrosura dhe të ndriçuara mirë, që ndihmojnë në përqëndrimin e nxënësve dhe rritin produktivitetin e mësimit.
e) Përdorimi i materialeve moderne dhe efikase për ngrohje dhe ftohje, për të garantuar një ambient komod gjatë gjithë vitit.
f) Ndërtimi i palestrës së mbyllur dhe mjediseve të laboratorëve

2. **Arsim Bazë: Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"**

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i kushteve të përshtatshme dhe të sigurta për fëmijët, për të garantuar që ata mund të frekuentojnë kopshtin në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme. Ky rikonstruksion i plotë është një mundësi për të modernizuar dhe përmirësuar infrastrukturën e kopshtit, duke ofruar një ambient të sigurt, komod dhe efikas energjetikisht, që do të kontribuoni në zhvillimin e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për prindërit dhe stafin. Kjo do të ishte një investim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve dhe komunitetit. Rikonstruksioni do të synojë të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijëve në aspekte të ndryshme, duke përfshirë edukimin, aktivitetet fizike dhe ato rekreative.

3. **Zhvillimi i Sportit: Ndërtimi i Ambjenteve Sportive Shkolla "28 Nëntori"**

Qëllimi i përgjithshëm i projektit Ndërtimi i Ambjenteve Sportive Shkolla "28 Nëntori" është;

kompletimi i palestrës me elementët e nevojshëm për të kryer aktivitetet të mbyllura sportive, si tavolina ping pongu, hapsira dhe element për zhvillimin e aktiviteteve të gjimnastikës, etj, paisje që shërbejnë për zhvillimin e orëve sportive.

E gjithë sipërfaqja e brendshme e ish – palestrës ka nevojë për rikonstruksion dhe rikonceptim të saj në një mjedis multifunksional ku mund të zhvillohen aktivtetet sportive. Në këtë mjedis mungojnë paisjet dhe infrastruktura e lehtë për të bërë të mundur zhvillimin e orëve mësimore sportive prandaj propozohet realizimi i këtij projekti i cili do të mundësojë zhvillimin e këtyre aktiviteteve brend godinës.

4. **Zhvillimi i Sportit: Ndërtim i ambjenteve Sportive të Shkollës "Tring Smajli"**

Rikualifikimi i ambienteve sportive në Shkollën "Tring Smajli" do të jetë në funksion të nxënësve por edhe të të rinjve të lagjes nr. 3 duke krijuar një mjedis të këndshëm në të cilin zhvillohen aktivitete sportive. Rimodelimi i të gjithë sheshit, si para ndërtesës, ashtu edhe prapa, e kthen këtë shësh në një hapësirë multifunksionale sportive dhe rekreative. Hapësirat sportive dhe rekreative do të mund të përdoren si nga nxënësit dhe mësuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti në territorin administrativ ku ndodhen shkolla

Përmes realizimit të këtij projekti synohet ndërtimi i 1 fushe të basketbollit 1 fushe për volejboll si dhe një fushe kalceto me përmasa 30m * 17m me mbulesë. Fushat e basketbollit dhe volejbollit do të jenë të kompletuara me të gjitha aksesorët sipas standardeve më të mira duke shtruar edhe terrenet me material rezinë që e bën më të sigurtë zhvillimin e aktivitetit sportiv. Gjithashtu do të realizohet edhe një pistë vrapimi me tartan.

Në zbatim të urdherit nr. 60 datë 07/02/2025 "Për shpalljen e thirrjes së parë për financim të projekteve nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i mesëm" dhe programi "Për zhvillimin e Sportit", Shtojcës nr. 1 Bashkia Shkodër duhet të bashkëfinancojë realizimin e këtyre projekteve në masën 25 % të vlerës totale.

**Sa më sipër referuar bazes ligjore:** Ligjit në mbështetje Ligjit nr. 9936, datë 26.6.20028 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të nenit 15, ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025", nenit 28, pika 2, neni 54 germa 'dh' të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar, VKB nr. 76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të bashkisë Shkodër", i ndryshuar, urdherit nr. 60 datë 07/02/2025 "Për shpalljen e thirrjes së parë për financim të projekteve nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i mesëm" dhe programi "Për zhvillimin e Sportit", urdhërit nr. 132, datë 02.04.2025 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2025 – 2026, nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i Mesëm" dhe programi "për Sportin", për infrastrukturën shkollore e sportive, Shkresës nr. 2174/1 datë 09.04.2025 "Njoftim për shpallje fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", për objekte shkollore të arsimit para universitar dhe programit për sportin, shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 11221 datë 04.06.2025 "Dërgohen shkresa nr. 8255/1 datë 27.05.2025 Transferim fondi për Shpenzime kapitale" kërkojmë nga ana e Juaj miratimin e këtij projekt vendimi për:

1. Miratimin e shtesës së planit të Buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektet kapitale të Arsimit Bazë, Arsimit të mesëm dhe Sportit:

**Shkolla e hapur "Ismail Qemali"** – me kosto totale zbatim projekti, supervizimi dhe kolaudimi në vlerën 301,686,815 lek
**Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"** - me kosto totale zbatimi projekti, supervizimi dhe kolaudimi në vlerën 46,708,842 lek
**Ndërtimi i Ambjenteve Sportive Shkolla "28 Nëntori"** - me kosto totale zbatimi projekti, supervizimi dhe kolaudimi në vlerën 17,059,340 lek
**Ndërtim i ambjenteve Sportive të Shkollës "Tring Smajli"** - me kosto totale zbatimi projekti, supervizimi dhe kolaudimi në vlerën 54,545,885 lek

Këto projekte bazuar në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 11221 datë 04.06.2025 "Dërgohen shkresa nr. 8255/1 datë 27.05.2025 Transferim fondi për Shpenzime kapitale" për objekte shkollore të arsimit para universitar dhe programit për sportin do të përfshihen në programet:

- **P09120.Q1.O3.A8. Rikonstruksion dhe ndertim palestre "Shkolla e hapur "Ismail Qemali"**, për zbatim të investimit në vlerën 224,854,662 lekë me tvsh në zërin Investime, prej të cilave 44,970,932 lekë për vitin 2025, 109,257,556 lekë për vitin 2026 dhe 70,626,174 lekë për vitin 2027, grante të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas fishës bashkëlidhur.

- **P09120.Q1.O3.A7. Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"**, për zbatim të investimit në vlerën 34,497,181 lekë me tvsh në zërin Investime, prej të cilave 6,899,436 lekë për vitin 2025, 27,597,745 lekë për vitin 2026 grante të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas fishës bashkëlidhur.
- **P.08140.Q1.O2.A2 Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit "28 Nëntori", Shkodër,** për zbatim të investimit në vlerën 12,565,933 lekë me tvsh në zërin Investime, prej të cilave 2,513,187 lekë për vitin 2025, 10,052,746 lekë për vitin 2026, grante të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas fishës bashkëlidhur.
- **P.08140.Q1.O2.A3 Ndërtim i ambjenteve Sportive të Shkollës "Tring Smajli"**, për zbatim të investimit në vlerën 40,032,610 lekë me tvsh në zërin Investime, prej të cilave 8,006,522 lekë për vitin 2025, 32,026,088 lekë për vitin 2026, grante të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas fishës bashkëlidhur .

2. Miratimin e fondit të bashkëfinancimit të projekteve nga buxheti i miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të bashkisë Shkodër", i ndryshuar" sipas fish projekteve bashkelidhur per shtesat e fondeve. në vlerën:

- **P.AI141.Q1.O3.A8. Rikonstruksion dhe ndertim palestre "Shkolla e hapur "Ismail Qemali"**, për zbatim, supervizim dhe kolaudim të investimit në vlerën 76,832,153 lek me tvsh në zërin Investime, të ndarë në dy vite përkatësisht viti 2025 shuma 46,851,531 lek dhe viti 2026 shuma 29,980,622 lek.
- **P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"**, për zbatim, supervizim dhe kolaudim të investimit në vlerën 12,211,661 lek me tvsh në zërin Investime, të ndarë në dy vite përkatësisht viti 2025 shuma 7,612,037 lek për vitin 2025 dhe viti 2026 shuma 4,599,624 lek.
- **P.AF141.Q1.O2.A2 Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit "28 Nëntori", Shkodër,** për zbatim, supervizim dhe kolaudim të investimit në vlerën 4,493,407 lek me tvsh në zërin Investime, të ndarë në dy vite përkatësisht viti 2025 shuma 2,817,949 lek dhe viti 2026 shuma 1,675,458 lek.

- **P.AF141.Q1.O2.A3 Ndërtim i ambjenteve Sportive të Shkollës "Tring Smajli"**, për zbatim, supervizim dhe kolaudim të investimit në vlerën 14,513,275 lek me tvsh në zërin Investime, të ndarë në dy vite përkatësisht viti 2025 shuma 9,175,594 lek dhe viti 2026 shuma 5,337,681 lek.

**NSHPP- Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike**

**1. Projekti: "A Lujmë Bashkë?" – Krijimi dhe Rikualifikimi i Hapësirave Rekreative për Fëmijët në Bashkinë Shkodër**

Në vijim të problematikave të vazhdueshme dhe kërkesave të shumta të qytetarëve lidhur me përmirësimin e hapësirave publike të dedikuara për lojëra dhe ambiente rekreative për fëmijët, paraqitet ky relacion për kërkesë fondesh shtesë nga buxheti i bashkisë së Shkodrës, i miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027", të ndryshuar.

Përmes këtij propozimi, synohet zbatimi i projektit **"A Lujmë Bashkë?"**, i cili ka si qëllim transformimin rrënjësor të mënyrës së kalimit të kohës së lirë për fëmijët e Bashkisë Shkodër. Loja është një element thelbësor në procesin e zhvillimit të fëmijëve, duke kontribuar në përmirësimin e aftësive fizike, emocionale dhe njohëse të tyre. Përmes lojës, fëmijët shprehin krijimtarinë, sfidojnë veten dhe ndërtojnë marrëdhënie sociale të shëndetshme.

Gjendja aktuale e këndeve të lojërave në territorin e bashkisë është kryesisht e amortizuar dhe e trashëguar nga vite të mëparshme, duke bërë të domosdoshme një ndërhyrje të menjëhershme dhe të thellë për ndërtimin dhe rikualifikimin e këtyre hapësirave.

Aktualisht, në territorin e bashkisë Shkodër funksionojnë çerdhe dhe kopshte publike e private me rreth **4600 fëmijë**. Po ashtu, një grup tjetër potencial për të përfituar nga këto hapësira janë edhe **11,800 nxënës** të shkollave 9-vjeçare të qytetit. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në mirëqenien e fëmijëve, projekti do të ketë gjithashtu një efekt pozitiv në jetën e familjeve, duke ofruar ambiente të sigurta, funksionale dhe të shpërndara në mënyrë të balancuar në të gjithë territorin e bashkisë.

**Objektivat kryesore të projektit janë:**

- Krijimi dhe rehabilitimi i këndeve të lojërave në lagje, parqe dhe institucionet arsimore publike;
- Sigurimi i aksesit të barabartë për të gjithë fëmijët në ambiente cilësore dhe të sigurta për lojë dhe zhvillim;
- Nxitja e aktivitetit fizik dhe socializimit tek fëmijët;
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës në komunitet përmes infrastrukturës rekreative.

Për realizimin e këtij projekti kërkohet alokimi i fondeve shtesë, duke e konsideruar këtë investim si një hap të domosdoshëm drejt ndërtimit të një qyteti më miqësor për fëmijët dhe familjet.

Sa më sipër kerkohet miratimin e shtesës se planit në **Programin AE141 "Shërbimet Publike Vendore" ne zerin Shpenzime kapitale në shumen 32,274,000 Lekë, P.AE141.Q2.O1.A4 - A Lujmë Bashkë?"** sipas fish-projektit bashkëlidhur.

2.Mbeshtetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, paraqesim propozimin fonde shtesë, **për përmirësimin e infrastrukturës së aksesit dhe sigurisë në plazhet publike të Bashkisë Shkodër, me fokus tek personat me aftësi të kufizuara dhe menaxhimin e qëndrueshëm të hapësirave turistike.**

Zhvillimi i plazheve publike dhe rritja e aksesit në këto hapësira është kthyer në një prioritet për Bashkinë Shkodër, sidomos në zonën e Velipojës, e cila është një nga destinacionet më të rëndësishme turistike të vendit. Në këtë kontekst, garantimi i **aksesit të barabartë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët**, përfshirë **personat me aftësi të kufizuara**, është një detyrë themelore dhe një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një mjedisi turistik gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Objektivat kryesore të ndërhyrjes:

1. **Instalimi i rrampave të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara**, të cilat lehtësojnë lëvizjen dhe hyrjen në ujë përmes karrocave me rrota ose ndihmësve të tjerë.

2. **Vendosja e tabelave informuese** përgjatë pedonales dhe në pika strategjike të plazhit për të orienuar qytetarët dhe vizitorët mbi vendndodhjen e plazheve publike dhe shërbimeve që ofrojnë.

REZULTATET E PRITSHME

- Përmirësim i **aksesit të pavarur dhe dinjitoz** për personat me aftësi të kufizuara;
- Krijimi i një mjedisi më të **informuar dhe të strukturuar për turistët**, duke ndikuar drejtpërdrejt në përvojën pozitive të vizitës;
- Mbështetje për strukturat e sigurisë publike dhe kufitare në menaxhimin e territorit.

---

Kjo ndërhyrje është e domosdoshme për t'iu përgjigjur:

- **rritjes së konsiderueshme të vizitorëve** në sezonin veror,
- nevojës për të respektuar **ligjin për aksesin e personave me aftësi ndryshe** në hapësira publike,

Sa më sipër kerkohet miratimin e shtesës se planit në VKB nr. 76 , datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër" , i ndryshuar. Kjo shtesë plani do të përfshihet në Buxhetin e Bashkisë Shkodër në **Programin AE141 "Sherbimet publike vendore"** sipas fishës P.AE141.Q3.O1.A3: Levizshmëria dhe sinjalistika, bashkëlidhur ne vleren 1 000 000 leke.

3. **SHPENZIME KORENTE**

1. **Mirembajtje e skemes ujitese**

Mirëmbajtje e skemës ujitëse fshati Gur I zi

Për një mbeshtetja më te mirë ndaj fermërve në Nj.A.Gur i Zi mendojmë se është e nevojshme një ndërhyrje ne rikonstruksionin e kanalit ujitës KU 20 i cili vendos në funksion të gjithë skemën ujitëse te Gurit te Zi, Pasi fillon ne Spathar dhe mbaron ne Rrenc,ky kanal furnizon me uje edhe investimin e ri që është bërë në këtë njesi, kanalin ujites KU 10, kjo nderhyrje përmirëson nje siperfaqe 500 ha.

Mirëmbajtje e skemës ujitëse fshati Boks-Dragoc-Kullaj

Një nderhyrje e domondoshme mendojmë se duhet të këryhet edhe Nj.A.Postrribë.
Riokonstruksioni i Kanali ujites Boks-Dragoc-Kullaj,është nje arterie e rëndesishme në procesin e ujitjes në këtë njesi,pasi furnizon me uje ,fshatrat Boks-Dragoc-Kullaj, përmirëson funksionimin e ujitjes ne 250 ha.

Mirëmbajtje e skemës ujitëse fshati Bardhaj-Bleran

Gjithashtu mëndojme se duke ndërhyre ne skemën ujitese të Bardhaj –Bleran në Nj.A.Rrethina do të ndihmojme fermerët e kesaj zone për rendimente më të larta dhe me cilesore. Kjo nderhyrje permirëson një siperfaqe 130 ha.

Mirëmbajtje e skemës ujitëse fshati Berdice

Në kuadrin e investimeve te kryera nga Bashkia Shkoder ne Nj.A.Berdice ,në rrjetin e Kanaleve Ujitese. Mendojmë se po të kryhet një ndërhyrje vazhduese në këtë rrjet, KU 33/3-2 do të përmirësonte këtë skemë ujtëse me një siperfaqe prej 200 ha. Zone e cila është me prodhim bujqesor intensiv.

Fondi shtese per mirembajtjen e skemes ujitese eshte sipas fishes bashkelidhe **P.AE141.Q1.O1.A4 Mirëmbajtje, rehabilitim i skemës ujitëse (Shtesë) ne vleren 27 850 000 leke.**

2. **Ofrimi i sherbimit te ujitjes**

Bashkia Shkodër në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, Neni 27 pika 1 eshte pergjegjese per administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Po ashtu ligji nr. 24/2017 " Për administrimin e ujitjes dhe kullimit", percakton detyrat dhe pergjegjesite qe kane bashkite per shfrytezimin dhe mirembajtjen e infrastruktures se ujitjes dhe kullimit te transferuar ne pronesi ne menyre qe te plotesoje nevojat per ujitje.

Që me marrjen e inventarit fizik të kanaleve kulluese dhe ujitëse të dyta dhe treta, Bashkisë Shkodër, i janë shtuar detyrimet për administrimin e një territori mjaft të gjerë dhe me një kompleksitet të madh problematikash, në administrimin e ujrave. Në përmbushje të këtij funksioni, Bashkia Shkoder ka tashme të organizuar punën për evidentimin e gjëndjes së kanaleve ujitëse (KU) dhe kanaleve kulluese (KK), ne menyre qe te realizoje nderhyrjet ne pastrimin, mirembajtjen dhe rehabilitimin e rrjetit ujites dhe kullues me qellim funksionimin sa me te mire te tyre ne funksion jo vetem te zhvillimit te qendrueshem te sektorit bujqesor por dhe te minimizimit te pasojave qe mund te shkaktohen nga permbytjet.

Gjëndja e rrjetit kullues dhe ujites edhe pse e permirësuar falë nderhyrjeve të viteve të fundit ka prapë shume nevoja, jo vetem ne kanalet qe nder vite nuk eshte nderhyre por dhe ne rehabilitim teresor te nje pjese te rrjetit si dhe pastrime periodike.

Per kete,Bashkia Shkodër në përgjigje të thirrjes për aplikim për projekte zbatimi për financimin e objekteve të ujitjes dhe kullimit të bashkive, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 226 datë 09.04.2024 " Për Shpërndarjen dhe Detajimin e Fondit për Financimin e Projekteve të Bashkive nga Programi " Menaxhimi I Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes" dhe Vendimin nr. 559 datë 11.09.2024 " Për një ndryshim në Vendimin Nr. 226 datë 09.04.2024 " Për Shpërndarjen dhe Detajimin e Fondit për Financimin e Projekteve të Bashkive nga Programi " Menaxhimi I Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes" ka aplikuar dhe përfituar financimin e 3 (tre) projekteve të zbatimit për rehabilitim të skemës ujitëse:

Kanali Kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush; Kanali Kryesor Mjedë KU-23 Trush ; Kanali Kryesor Mjedë KU-23-1 Trush ; Kanali Kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush; Kanali Kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush me gajatësi totale 12,024 ml dhe vlerë financimi për 2 vite prej 75,560,770 lekë

Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç, me gjatësi 6,747 ml dhe vlerë financimi për 3 vite prej 51,853,884 lekë

KU 32-33 Bërdicë me gjatësi 6,153 ml dhe vlerë financimi për 3 vite prej 44,539,557 lekë.

Realizimi i këtyre projekteve rehabilitimi i cili eshte ne proces përmirëson dukshëm mundësinë e ujitjes së tokave bujqësore në një sipërfaqe prej me shume se 1700 Ha nga e cila përfitojnë rreth 1270 fermerë. Me qëllim përmirësimin e shërbimit të ujitjes në zonat ku ofrohet ky shërbim, dhe zgjerimin e hartës së mbulimit me këtë shërbim, është përllogaritur kostoja e tarifës së këtij shërbimi referuar në

shpenzimeve të kryera për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, duke përfshijë çdo shpenzim të bërë për furnizimin me ujë.
Për vjeljen e tarifës së ujitjes do jenë të punësuar 10 punonjës sezonal për një periudhe 5 mujore, të cilët do kenë si detyrë gjithashtu menaxhimin e ujit për ujitje sipas kërkesave të fermerëve.
Ne kete menyre sigurohet ofrimi i nje sherbimi me te mire per fermeret gjate sezonit te ujitjes gjithashtu dhe me ane te vjeljes se tarifes se ujitjes sigurohen fonde te cilat shkojne ne permiresimin e metejshem te rrjetit ujites dhe kullues.
Fondi shtese per ofrimin e sherbimit te ujitejes eshte sipas fishes bashkelidhe **P.AE141.Q1.O1.A5 Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma ne vleren 3 372 000 leke.**

3. **Blerje materiale elektrike per reabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder - Mes**
Aksi Shkoder - Mes i cili fillon nga Ura e Bardhajve dhe perfundon ne Mes (Nj.A. Postribe), ka pasur nje sistem ndricimi jofunksional qe nga viti 2013 (pak pas ndertimit te tij). Me ane te ketij fondi, Bashkia Shkoder synon qe te bleje materialet e nevojshme, si ndricues LED, shtylla konike, morseteri dhe panele komandimi, per rivendosjen ne funksionit te ndricimit publik per kete aks te rendesishem. Ky aks ka nje rendesi te vecante pasi vitet e fundit eshte rritur numri i popullsise qe banojne ne kete zone, po ashtu perdoren edhe nga turistet per te vizituar atraksione turistike si Ura e Mesit, Kalaja e Drishtit, Prekal etj. Fondi shtese eshte sipas fishes bashkelidhe **P.AE141.Q7.O1.A6 Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Njësive Administrative (Shtesë)ne vleren 9 800 000 leke.**

## 4. INVESTIME

1. **Blerje pajisje pune për sektorin e mirëmbajtjes së infrastrukturës**

Në konceptin e mirëmbajtjesë së rrugëvë, është një punë qe realizohet gjatë gjithë vitit, si rrjellojë lind nevoja e përshtatjes për kryerjen e puneve dhe në kushte atmosferike jo të mira. Për këtë eshte e nevojshme te blihen paisje pune cilësore me përdorim shumë-stinësh.
Njëkohësisht, duke qene vazhdimisht të ekspozuar me punë në rugë, më ngarkesë trafiku në kuadër të kryerjeve të shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës lind nevoja e pajisjes me materiale sigurie. **Vlera e planifikuar eshte 2 600 000 leke , sipas fishes bashkelidhe.**

2. **Blerje mjeti minieskavator**

Nisur nga nevojat dhe natyra e punës së NSHPP, nevojitet të blihet një mjet i tipit minieskavator. Ky mjet nevojitet për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes kryesisht në qytet, ku mundësia e lëvizshmërisë dhe aksesit është e kufizuar. Gjithashtu ky mjet është i domosdoshëm për kryerjen e ndërhyrjeve në lagjet e qytetit, si dhe në riparimet e infrastrukturës rrugore në qytet, me qëllim që gjatë punimeve të mos bllokohet trafiku dhe shmangien e kaosit në lëvizje. **Vlera e planifikuar eshte 4 500 000 leke , sipas fishes bashkelidhe.**

3. **Blerje makinë vijëzimi**

Blerje nje makineri vijezimi me goma, me lazer dhe sensore te ndryshem me se e domosdoshme kjo si rjedhoje e sasise se madhe te vijave te kembesoreve dhe vijezime ne korsite e bicikletve dhe permiresimit te vijezimeve ne qytet dhe Njesite Administrtive, kjo ne kudrin e mobilitetit urban te qytetit me pasjen e sinjalistikes bashkohore, per rritjen e sigurise ne rruge te kembesoreve, levizjen

e mjeteve pedaluese si dhe tyre motorike. **Vlera e planifikuar eshte 3 600 000 leke , sipas fishes bashkelidhe.**

4. **Blerje kazanësh**

Problematikat e vazhdueshme qe hasim ne pune e perditshme me demtimin e kazaneve, amortizimin e tyre, ben qe te lindin nevoja per zevendesimin e tyre here pas here. Gjithashtu eshte e nevojshme shtimi i kazaneve ne Njesite administrative te Bashkise Shkoder, e me me prioritet ne zonat me fluks te madh turistesh, siç eshte zona e Velipojes, e Shiroke-Zogaj dhe ajo e Thethit, por pa anashkaluar edhe zona te tjera me rritje gjithnje e me te madhe te numrit te turisteve. **Vlera e planifikuar eshte 15 000 000 leke , sipas fishes bashkelidhe.**

5. **Blerje kamioni me vinç per pastrim te hotspoteve**

Me gjithe perpjekjet e vazhdueshme per pastrimin e hotspoteve te krijuara kryesisht ne vend depozitime te ndryshme te pamiratuara, ne zonat periferike te qytetit si dhe pergjate rrugeve te njesive administrative, ne zonat turistike kryesisht ne zonen e plazhit Velipoje, mbetet nje problematik ne vazhdim. Per kete kerkohet blerja e nje mjeti me vinç te pershtatshem per pastrimin e ketyre mbetjeve voluminoze dhe te gjelberta si dhe transportimin e tyre. **Vlera e planifikuar eshte 4 000 000 leke , sipas fishes bashkelidhe.**

6. **Investim ne reabilitimin e ndricimit ne rrugen Kardinal Mikel Koliqi**

Ne vazhdim te investimeve per reabilitimin e ndriçimit publik te rrugeve pedonale te qytetit te Shkodres, pas perfundimit vitin e kaluar te rruges Gjuhadol dhe investimin e vitit 2025 per reabilitimin e rruges Jeronim De Rada, u mendua qe te vazhdohet investimi ne rrugen e trete te kryqezimit te Truma, rruga Kardinal Mikel Koliqi. Ky investim do te realizohet me ndricim LED te teknologjise se fundit, me shtylla qe pershtaten me arkitekturen e kesaj zone, dhe me sistem automatik te komandimit te tyre. Ndricuesat 30W ku u perdoren ne rrugen Gjuhadol, po ashtu te njejtit qe do te perdoren ne rrugen Jeronim De Rada, pervec parametrave me te mire te ndricimit, do te kene edhe nje konsum 5 here me te vogel sesa ndricuesit e perdorur aktualisht. Bashkia Shkoder, me kete projekt do te vertetoje edhe njehere se pavarsisht se zona tipike muzeale e rrugeve pedonale do te influencoje perzgjedhjen e ndricuesve te perdorur, ndricuesat me kursim energjie per zbatimin e planit te klimes dhe energjise do vazhdojne te jene ne fokus te institucionit, ku dhe Bashkia Shkoder eshte avangard ne te gjithe Shqiperine per marrjen e ketyre masave. **Vlera e planifikuar eshte 8 000 000 leke , sipas fishes bashkelidhe.**

**DPMOP- Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike**

**1. Shtese fondi paga dhe sigurime shoqerore.**

Në kuadër të intensifikimit të veprimtarisë institucionale dhe zgjerimit të gamës së shërbimeve që ofron Bashkia Shkodër, është bërë e nevojshme rishikimi dhe përforcimi i kapaciteteve njerëzore për periudhën e verës dhe më gjerë. Aktualisht, struktura ekzistuese e punonjësve nuk mund të përmbushë në mënyrë optimale nevojat e reja që kanë lindur nga shtimi i funksioneve dhe aktiviteteve të bashkisë, si më poshtë:

Vendosja në funksion të Kinemasë Republika së Shkodrës, si një qendër multifunksionale kulturore, kërkon praninë e stafit teknik dhe logjistik për operimin e sallave, mirëmbajtjen, sigurinë, si dhe organizimin e aktiviteteve artistike.

Menaxhimi i plazheve publike pa pagesë në Velipojë, përfshirë mirëmbajtjen, mbikëqyrjen, ofrimin e shërbimeve minimale për sigurinë dhe pastërtine gjatë sezonit turistik është një detyrë e re që kërkon angazhimin e personelit në terren.

Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike në territorin e bashkisë, si festivale, evente promovuese, ekspozita, aktivitete rinore e sportive, kërkon staf mbështetës për logjistikën, komunikimin dhe sigurinë e pjesëmarrësve.

Për të siguruar një menaxhim efektiv të këtyre proceseve dhe për të shmangur mbingarkesën mbi strukturat aktuale, propozohet shtimi i numrit të punonjësve, të cilët do të angazhohen me detyra të qarta sipas urdhrave të punës dhe nevojave operacionale të çdo sektori.

- 2 (dy) sanitare te Kinema Republika | Fisha **P.AF141.Q2.O3.A1/1.** Paga dhe sigurime shoqërore për stafin për punonjësit mbështetës te Kinema Republika.
- 2 (dy) sanitare për mirëmbatjen e tualeteve Velipojë | Fisha **P.AG141.Q1.O1.A2.** Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor.
- 1 (një) sanitare për Qendrat Komunitare | Fisha **P.AG141.Q2.O1.A1/1** Paga dhe Sigurime per ofrimin e kujdesit shoqeror per familjet dhe femijet (Qendra Komunitare).

## 2.Rikonstruksion Kopshti Bep Tusha

Bashkia Shkodër ka një numër prej 51 objektesh të cilat janë në funksion të kopshteve me një numër prej 1712 fëmijësh që i frekuentojnë. Duke pasur një numër të madh të këtyre objekteve në vite edhe problematikat e amortizimit të tyre janë të mëdha. Bashkia Shkodër përmes krijimit të Ndërrmarrjes së Mirëmbajtjes së Objekteve Publike arrin që përgjatë vitit të kryejë mirëmbajtje të zakonshme në godinat e kopshteve duke ndërhyrë në rikualifikime të ndryshme.

Konkretisht përmes këtij projekt propozimi synohet që të bëhet rikualifikimi total i kopshtit Bep Tusha . Ky kopësht shërben edhe si çerdhe dhe është nga më të mëdhenjt në qytet me një numër prej 144 fëmijësh që e frekuentojnë duke qënë se ndodhet në lagjen nr. 1 të qytetit.

Krijimi i mjediseve të përshtatshme për frekuentim të kopshteve është një prioritet i bashkisë Shkodër i cili lidhet ngushtësisht me cilësinë e jetesës së banorëve. Cdo lagje e njësi administrate duhet të ketë mjedise me kushte të përshtatshme në të cilat fëmijët të kenë mundësinë që të akomodohen dhe të rriten e zhvillohen sipas të gjitha standardeve. Projekti Rikonstruksion i kopshtit Bep Tusha synon pikërisht rikonstruksionin e këtij kopshti sipas standardeve për ta rivitalizuar dhe venë në kushte sipas të gjitha parametrave më të mirë.

Situata aktuale e godinës është plotësisht e amortizuar dhe është e nevojshme që të ketë një rikonstruksion total duke qënë se përmes mirëmbajtjes së zakonshme është e pamundur që të krijohen kushtet e përshtatshme të frekuentimit dhe konfortit.

Gjendja aktuale e ndërtesës së kopshtit "Bep Tusha" tregon nevojën urgjente për një rikonstruksion të plotë dhe modernizim, pasi infrastruktura e saj nuk përmbush kërkesat bashkëkohore për sigurinë, komoditetin dhe efikasitetin energjetik. Disa nga problemet kryesore që kërkojnë ndërhyrje janë:

1. Mungesa e Hapësirave të Përshtatshme për Fëmijët dhe Prindërit

Ambjentet pritëse të fëmijëve dhe prindërve janë të amortizuara dhe nuk kanë konformtin e nevojshëm.

Ambienti i gatimit dhe ngrënies është tepër i vogël për të akomoduar një numër të mjaftueshëm fëmijësh, dhe nuk ofron kushte të përshtatshme për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit në një mjedis të sigurt dhe komod.

Tualetet janë të papërshtatshme për përdorim nga fëmijët, duke mos i plotësuar standardet higjienike dhe sigurinë e nevojshme për këtë kategori moshe.

2. Problematika me Ambientet e Pushimit dhe Komoditetin e Fëmijëve

Ambjentet e pushimit për fëmijët janë të prekur nga probleme të theksuara të lagështirës, duke ndikuar negativisht në shëndetin e fëmijëve dhe sigurinë e mjedisit.

Ajrimi dhe ndriçimi i këtyre ambienteve është gjithashtu problematik, duke e bërë të vështirë sigurimin e kushteve optimale për zhvillimin e fëmijëve.

Mjediset e jashtme janë të degraduara dhe pa hapsirat e përshtatshme për organizimin e aktiviteteve rekreative në oborr për fëmijët

3. Sistemi i Ngrohjes dhe Ftohjes

Sistemi aktual i ngrohjes nuk është në gjendje të përballojë ngarkesat e kërkuara nga rrjeti elektrik, duke e bërë të vështirë mbajtjen e temperaturave të përshtatshme në dimër. Kjo çon në krijimin e një ambienti të papërshtatshëm dhe të pasigurt për fëmijët dhe stafin.

Nevoja për një sistem ngrohje dhe ftohje të ri dhe efikas është urgjente, jo vetëm për të siguruar komfortin e fëmijëve, por edhe për të rritur sigurinë e ambientit.

4. Problematika me Infrastrukturën dhe Efikasitetin Energjitik

Godina nuk ka izolim adekuat, me mure dhe çati të pa izoluara, dhe dritare të pa përputhura me standardet energjetike, duke çuar në humbje të energjisë dhe rritje të kostove operative.

Ndriçimi është po ashtu i papërshtatshëm dhe jo i efikas, pasi përdoren drita jo LED, të cilat janë më pak efikase dhe më të shtrenjta për t'u përdorur.

Me një ndërtesë që nuk ofron efikasitet energjetik dhe me sistemet dhe pajisjet që nuk janë në përputhje me kërkesat moderne, kemi edhe keqmenaxhim duke rritur kostot e mirëmbajtjes dhe operimit të objektit.

Nevoja për Rikonstruksion të Plotë dhe Modernizim

Për të adresuar këto probleme dhe për të krijuar kushte të përshtatshme për fëmijët dhe stafin, është e domosdoshme një ndërhyrje e plotë dhe e thelluar në ndërtesë. Rikonstruksioni duhet të përfshijë:

Përmirësimi i hapësirave për fëmijët dhe prindërit:

Rikualifikimi dhe rikonceptimi i ambjenteve të akomodimit të fëmijëve dhe mjediseve pritëse

Zgjerimi i ambienteve të gatimit dhe ngrënies për t'u mundësuar fëmijëve kushte më të mira për ushqim dhe përgatitje.

Rikonstruksioni i tualeteve për t'i bërë ato më të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët.

Përmirësimi i ambienteve të pushimit:

Eliminimi i lagështirës dhe përmirësimi i ajrimit dhe ndriçimit për të krijuar kushte të shëndetshme dhe komode për fëmijët gjatë pushimeve.

Rikonstruksioni i sistemit të ngrohjes dhe ftohjes:

Zëvendësimi i sistemit aktual të ngrohjes me një sistem të ri që mund të përballojë kërkesat energjitike të ndërtesës, duke garantuar një ambient të ngrohtë dhe të sigurt për fëmijët dhe stafin.

Përmirësimi i efikasitetit energjetik:

Izolimi i murëve dhe çatisë për të përmirësuar efikasitetin energjitik dhe për të ulur humbjet e energjisë.

Përdorimi i dritareve dhe materialeve me standarde të larta efikasiteti energjetik.

Zëvendësimi i sistemit të ndriçimit me teknologji LED për të kursyer energji dhe për të siguruar ndriçim më të mirë.

Krijimi i kushteve të sigurisë dhe efikasitetit:

Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe të sigurta për fëmijët, për të garantuar që ata mund të frekuentojnë kopshtin në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme.

Ky rikonstruksion i plotë është një mundësi për të modernizuar dhe përmirësuar infrastrukturën e kopshtit, duke ofruar një ambient të sigurt, komod dhe efikas energjetikisht, që do të kontribuoni në zhvillimin e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për prindërit dhe stafin. Kjo do të ishte një investim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve dhe komunitetit.

Rikonstruksioni do të synojë të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijëve në aspekte të ndryshme, duke përfshirë edukimin, aktivitetet fizike dhe ato rekreative.

Krijimi i hapësirave të përshtatshme për aktivitete të ndryshme që stimulojnë zhvillimin e shkathtësive sociale, kreative dhe fizike të fëmijëve.

Ky projekt rikonstruksioni do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të edukimit për fëmijët, duke i ofruar atyre një ambient të sigurt, të ngrohtë dhe të përshtatshëm për zhvillimin e plotë të potencialeve të tyre. Rikonstruksioni do të përfshijë mjediset e brendshme dhe të jashtme të këtij kopshti sipas standardeve të ndërtimit të objekteve të tilla duke e rikonceptuar si nje mjedis multifunksional e rekreativ që nxit zhvillimin e fëmijëve.

Aktualisht objekti ka një oborr prej 1500 m2 nga te cilat godina e kopshtit zë 700m2. Vendnodhja e objektit të propozuar për ndërhyrje, sipas ortofotos ndodhet në lagjen nr. 1 të qytetit të Shkodrës, në një nga lagjet me densitet të lartë të popullsisë.

- **Kostot e zbatimit : 55,916,241 leke**
- **Kosto e kolaudimit : 51,166 leke**
- **Kostot e mbikëqyrjes: 784,562 leke**
- **Kostot e projektimit : 1,933,385 leke**
- **Kostot e totale : 58,685,354 leke**

Për këtë arsye lind e nevojshme parashikimi i një fondi për mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor.(kjo sipas fishes bashkelidhe P.AI141.Q1.O3 .A3 Rikonstruksion i kopshtit Bep Tusha )

**3.Rikonstruksion Shkolla Salo Halili**

Bashkia Shkodër ka një numër prej 75 objektesh të cilat janë në funksion të shkollave me një numër prej 14 609 fëmijësh që i frekuentojnë. Duke pasur një numër të madh të këtyre objekteve në vite edhe problematikat e amortizimit të tyre janë të mëdha. Bashkia Shkodër përmes krijimit të Ndërmarrjes së

Mirëmbajtjes së Objekteve Publike arrin që përgjatë vitit të kryejë mirëmbajtje të zakonshme në godinat e shkollave duke ndërhyrë në rikualifikime të ndryshme.

Konkretisht përmes këtij projekt propozimi synohet që të bëhet studim - projektimi për rikualifikimi total i shkollës Salo Halili .

Nder synimet e Bashkisë Shkodër është rritja e aftësisë se thithjes se investimeve, duket gjetur donator te ndryshëm. Hapi i pare për gjetjen e investimeve dhe donatoreve është pajisjeve me projekte sa me dinjitarë

Ndaj dhe ky projekt propozim , kërkon nga ana juaj financimin e këtij studim - projektimi

Gjendja aktuale e ndërtesës së shkolla Salo Halili tregon nevojën urgjente për një rikonstruksion të plotë dhe modernizim, pasi infrastruktura e saj nuk përmbush kërkesat bashkëkohore për sigurinë, komoditetin dhe efikasitetin energjetik , prandaj kërkojmë qe sa me shpejt te pajisemi me një projekt te përshtatshëm si faza e pare e zgjidhjes se këtij problemi

Ambientet pritëse të fëmijëve janë të amortizuara dhe nuk kanë komfortin e nevojshëm.

Objekti ngrohet me ngrohëse lokale me dru, duke paraqit një nivel komforti dhe sigurie jo te larte

Godina nuk ka izolim adekuat, me mure dhe tarracë të pa izoluara termikisht , dhe dritare të pa përputhura me standardet energjetike, duke çuar në humbje të energjisë dhe rritje të kostove operative.Ndriçimi është po ashtu i papërshtatshëm dhe jo i efikas, pasi përdoren drita jo LED, të cilat janë më pak efikase dhe më të shtrenjta për t'u përdorur.

Me një ndërtesë që nuk ofron efikasitet energjetik dhe me sistemet dhe pajisjet që nuk janë në përputhje me kërkesat moderne, kemi edhe keq menaxhim duke rritur kostot e mirëmbajtjes dhe operimit të objektit.

Rikualifikimi dhe ri konceptimi i ambienteve të akomodimit të fëmijëve dhe mjediseve sportive

Rikonstruksioni i tualeteve për t'i bërë ato më të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët dhe PAK.

Zëvendësimi i sistemit aktual të ngrohjes me një sistem të ri që mund të përballojë kërkesat energjetikë të ndërtesës, duke garantuar një ambient të ngrohtë dhe të sigurt për fëmijët dhe stafin.

Izolimi i mureve dhe tarracës për të përmirësuar efikasitetin energjetik dhe për të ulur humbjet e energjisë.

Përdorimi i dritareve dhe materialeve me standarde të larta efikasiteti energjetik.

Zëvendësimi i sistemit të ndriçimit me teknologji LED për të kursyer energji dhe për të siguruar ndriçim më të mirë.

Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe të sigurta për fëmijët, për të garantuar që ata mund të frekuentojnë shkollen në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme.

Duke pajisur godinën me një sistem mbrojtje dhe sinjalizimi për rastet e zjarrit, me dalje emergjence etj.

Ky projekt-studim rikonstruksioni do te jete një mundësi për të modernizuar dhe përmirësuar infrastrukturën e shkollës , duke ofruar një ambient të sigurt, komod dhe efikas energjetiket, që do të kontribuoni në zhvillimin e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për prindërit dhe stafin. Kjo do të ishte një investim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve dhe komunitetit.

Aktualisht objekti ka një oborr prej 5586 m2 nga te cilat godina e shkolles zë 1007 m2.

- **Kostot e projektimit :** 6 000 000 leke

Për këtë arsye lind e nevojshme parashikimi i një fondi për mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor. ( kjo sipas fishes bashkelidhe P.AI141.Q1.O3 .A9 Rikonstruksion Shkolla Salo Halili )

**4.Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi**

Bashkia Shkodër përmes krijimit të Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Objekteve Publike arrin që përgjatë vitit të kryejë mirëmbajtje të zakonshme në godinat e shkollave duke ndërhyrë në rikualifikime të ndryshme.

Konkretisht përmes këtij projekt propozimi synohet që të bëhet studim-projektimi për rikualifikimin total te shkollës Ndoc Mazi .

Nder synimet e Bashkisë Shkodër është rritja e aftësisë se thithjes se investimeve, duket gjetur donator te ndryshëm. Hapi i pare për gjetjen e investimeve dhe donatoreve është pajisjeve me projekte sa me dinjitarë

Shkolla Ndoc Mazi paraqet nje situtate te amortizur dhe nje godine qe nuk ploteson shume kushte dhe standarde ne fuqi , per ndricimin , ajerimin, komoditetin, ngrohjen etj

Objekti ngrohet me ngrohëse lokale me dru, duke paraqit një nivel komfortit dhe sigurie jo te larte , prandaj e shikojme te nevojshme te behet me nje sistem ngrohje apo kondicionimi qendror

Shkolla nuk ka asnje lloj termoizolimi as ne mure as ne dritare , po ashtu dhe ndricimi nuk eshte LED, duke rritur ndjeshem faturat per funksionimin e shkolles.

Shkolla sot ka vetem nje fushe sportive e cila nuk mjafton per te gjithe nxenesit , dhe sot eshte mjaft e amortizuar , pa ndricim dhe pikon ne disa vende

Duke pajisur godinën me një sistem mbrojtje dhe sinjalizimi për rastet e zjarrit, me dalje emergjence etj.

Ky projekt-studim rikonstruksioni do te jete një mundësi për të modernizuar dhe përmirësuar infrastrukturën e shkollës , duke ofruar një ambient të sigurt, komod dhe efikas energjetikisht, që do të kontribuoni në zhvillimin e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për prindërit dhe stafin. Kjo do të ishte një investim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve dhe komunitetit.

Aktualisht objekti ka një oborr prej 3375 m2 nga te cilat godina e shkolles zë 865 m2.

- **Kostot e projektimit :** 6 000 000 leke

Për këtë arsye lind e nevojshme parashikimi i një fondi për mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor.

( kjo sipas fishes bashkelidhe P.AI141.Q1.O3 .A10 Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi

**5.Rikonstruksion Biblioteka Marin Barleti**

Bashkia Shkodër me Biblioteken MArin Barleti ka nje fond per 250 000 librash, revistash etj , ne nje godine ne te cilen vitin e kaluar jane kryer 70 aktivitete te ndryshme dhe qe pret afersisht 100 lexues te ndryshem ne dite.

Nder synimet e Bashkisë Shkodër është rritja e aftësisë se thithjes se investimeve, duket gjetur donator te ndryshëm. Hapi i pare për gjetjen e investimeve dhe donatoreve është pajisjeve me projekte sa me dinjitarë.

Ndaj dhe ky projekt propozim , kërkon nga ana juaj financimin e këtij studim - projektimi

Situata aktuale e godinës është plotësisht vjeteruar dhe e amortizuar dhe është e nevojshme që të ketë një rikonstruksion total duke qene se përmes mirëmbajtjes së zakonshme është e pamundur që të krijohen kushtet e përshtatshme të frekuentimit dhe komfortit.

Gjendja aktuale e ndërtesës së bibliotekes Marin Barleti tregon nevojën urgjente për një rikonstruksion të plotë dhe modernizim, dhe rikonceptim te sajin pasi infrastruktura e saj nuk përmbush kërkesat bashkëkohore për sigurinë, komoditetin dhe efikasitetin energjetik

.Disa nga shqetësimet kryesore që kërkojnë ndërhyrje janë:

1. Mungesa e Hapësirave të Përshtatshme për fëmijët , studentet dhe studiues te ndryshem

Ambientet pritëse per lexuesit janë të amortizuara dhe nuk kanë komfortin e nevojshëm, si per nga ndricimi , qetesi , arredim etj

2. Sistemi i Ngrohjes dhe Ftohjes

Objekti ngrohet dhe ftohet ne disa ambiente me kondicioner lokal , duke paraqit një nivel komfortit dhe sigurie jo te larte , dhe nje godine qe ne ditet me temperatura ekstreme behet e pa perdorshme

3. Problematika me Infrastrukturën dhe arredimin

Objekti nuk ka nje salle konferencash te mirefillte. Po ashtu salla e ekspozimit eshte e improvizuar .

Arredimi i godines permban akoma nje pjese te karrigeve dhe raftave te para viteve 90

Godina nuk ka izolim adekuat, me mure dhe tarraca të pa izoluara termikisht , dhe dritare të pa përputhura me standardet energjetike, duke çuar në humbje të energjisë dhe rritje të kostove operative.

Fondi dhe arkivat jane ne nje gjendje te mjerueshme dhe rrezikojne ne kohe demtimin e tyre

Zëvendësimi i sistemit aktual te kondicionimit me një sistem të ri që mund të përballojë kërkesat energjetikë të ndërtesës, duke garantuar një ambient të ngrohtë dhe të sigurt për fëmijët dhe stafin.

Izolimi i mureve dhe çatise për të përmirësuar efikasitetin energjetik dhe për të ulur humbjet e energjisë.

Krijimi i kushteve të sigurisë dhe efikasitetit:

Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe të sigurta për fëmijët, për të garantuar që ata mund të frekuentojnë kopshtin në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme.

Duke pajisur godinën me një sistem mbrojtje dhe sinjalizimi për rastet e zjarrit, me dalje emergjence etj.

Ky projekt-studim rikonstruksioni do te jete një mundësi për të modernizuar dhe përmirësuar infrastrukturën e bibliotekes , duke ofruar një ambient të sigurt, komod dhe efikas energjetikisht, që do të kontribuoni në zhvillimin e fëmijëve , lexuesve dhe studiuesve me përmirësimin e kushteve. Kjo do të ishte një investim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve dhe komunitetit.

- **Kostot e projektimit :** 6 000 000 leke

Për këtë arsye lind e nevojshme parashikimi i një fondi për mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor. ( kjo sipas fishes bashkelidhe P.AF141.Q2.O3.A23 Rikonstruksion Biblioteka Marin Barleti ) .

Shtesa

Në lekë

| Institucioni | Pr. | Emërtimi i Aktivitetit | Detajim Viti 2025 | | | | | | | Detajim Viti 2026 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Projekte | Investime | Totali 2025 | Investime | Totali 2026 |
| Bashkia Shkodër | AA141 | P.AA141.Q1.O1.A1. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe honorare për kryetarët e fshatrave (shtesë) | 2,038,523 | 324,215 | | | | | 2,362,738 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q1.O1.A3 Anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (shtesë) | | | | 1,630,200 | | | 1,630,200 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q3.O2.A1. Detyrime dhe kompensime legale (shtesë) | | | 340,094 | | | | 340,094 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q3.O4.A1 .Paga per drejtorine e te ardhurave, pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore dhe shpenzime korente dhe kapitale (shtesë) | 1,302,788 | 207,200 | | | | | 1,509,988 | | |
| | AA141 | P.AA141.Q3.O5.A4 Blerje Licenca Software | | | | | 5,000,000 | | 5,000,000 | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | AB141 | P.AB141.Q2.O1.A6 Reduktimi i pasojave të përmbytjes | | | | | | 12,414,478 | 12,414,478 | | |
| | AC141 | P.AC141.Q4.O1.A3. Ndërtimi i Zyrës së re InfoPoint | | | | | 398,000 | 8,176,000 | 8,574,000 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A1 Paga dhe sigurime te personelit te Teatrit "Migjeni" dhe Kinema Republika (shtesë) | 329,438 | 52,395 | | | | | 381,833 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A15. Realizimi i Aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kulturës (shtesë) | | | | 4,100,000 | | 3,400,000 | 7,500,000 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete në partneritet me të tretë (shtesë) | | | | 6,000,000 | | | 6,000,000 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O1.A1. Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor ( paga/sigurime shoqerore ) (shtesë) | 915,810 | 145,655 | | | | | 1,061,465 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O1.A2. Mbështetja e personelit mbështetës për arsimin bazë. (paga/sigurime shoqërore) dhe stafi i drejtorisë ( shtesë) | 901,740 | 143,415 | | | | | 1,045,155 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q3.O1.A1 Mbështetja e personelit të çerdheve (Paga dhe sigurime shoqërore) (shtesë) | 976,448 | 155,300 | | | | | 1,131,748 | | |
| Bashkia | AF141 | P.AF141.Q1.O2.A2 Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit | | | | | | 2,817,949 | 2,817,949 | 1,675,458 | 1,675,458 |

BASHKIA SHKODËR

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër | | "28 Nëntori", Shkodër | | | | | | | | | |
| | AF141 | P.AF141.Q1.O2.A3 Ndërtim i ambienteve Sportive të Shkollës "Tring Smajli" | | | | | | 9,175,594 | 9,175,594 | 5,337,681 | 5,337,681 |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3.A8. Rikonstruksion dhe ndërtim palestre "Shkolla e hapur "Ismail Qemali" | | | | | | 46,851,531 | 46,851,531 | 29,980,622 | 29,980,622 |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli" | | | | | | 7,612,037 | 7,612,037 | 4,599,624 | 4,599,624 |
| Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike | AE141 | P.AE141.Q1.O1.A4 Mirëmbajtje, rehabilitim i skemës ujitëse (Shtesë) | | | 27,850,000 | | | | 27,850,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q1.O1.A5 Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma | 2,909,000 | 463,000 | | | | | 3,372,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q1.O1. A3 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (Shtesë) | | | | | | 7,100,000 | 7,100,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q3.O1.A3 Lëvizshmëria dhe sinjalistika (Shtesë) | | | 300,000 | | | 4,300,000 | 4,600,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q4.O2.A2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane (Shtesë) | | | | | | 19,000,000 | 19,000,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q2.O1.A4 A Lujmë Bashkë? | | | | | 1,519,000 | 30,755,000 | 32,274,000 | | |
| | AE141 | P.AE141.Q7.O1.A5 Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit (Shtesë) | | | | | | 8,000,000 | 8,000,000 | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | AE141 | P.AE141.Q7.O1.A6: Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Njësive Administrative (Shtesë) | | | 9,800,000 | | | | 9,800,000 | | |
| Drejtoria e Përgjithshme Mirëmbajtjes së Objekteve Publike | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A1/1 Paga dhe sigurime shoqërore për stafin për punonjësit mbështetës te Kinema Republika | 837,900 | 133,266 | | | | | 971,166 | | |
| | AG141 | P.AG141.Q1.O1.A2 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor | 837,900 | 133,266 | | | | | 971,166 | | |
| | AG141 | P.AG141.Q2.O1.A1/1 Paga dhe Sigurime per ofrimin e kujdesit shoqeror per familjet dhe femijet (Qendra Komunitare) | 433,650 | 68,971 | | | | | 502,621 | | |
| | AF141 | P.AF141.Q2.O3.A23 Rikonstruksion Biblioteka Marin Barleti | | | | | 6,000,000 | | 6,000,000 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3 .A10 Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi | | | | | 6,000,000 | | 6,000,000 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3 .A9 Rikonstruksion Shkolla Salo Halili | | | | | 6,000,000 | | 6,000,000 | | |
| | AI141 | P.AI141.Q1.O3 .A3 Rikonstruksion i kopshtit Bep Tusha | | | | | 1,933,385 | 56,751,969 | 58,685,354 | | |
| | | **TOTALI** | **11,483,196** | **1,826,683** | **38,290,094** | **11,730,200** | **26,850,385** | **216,354,558** | **306,535,116** | **41,593,385** | **41,593,385** |

**KRYETAR**

**Benet BECI**

*Zv. Kryetar*

*Zv. Kryetar*

*Zv. Kryetar*

*Drejtoria e Pergjithshme e MF*

*Drejtoria Pergjith.Juridike,BNJ dhe Sherbimeve mbeshtetese*

*Drejtoria e të Ardhurave*

*Drejt e Pergjith. e Zhvillimit Qendrueshem ekonomik*

*Drejtoria e Pergjith Kulturës dhe Sportit*

*Ndermarrja e Shërbimeve dhe puneve Publike,*
*NA*
*NZ*

*Drejtoria e Arsimit*

*Drejtoria e Pergjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Rinise*

*Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike*
*NA*
*NZ*

*Drejtoria e Emergjencave Civile*

IMT

Drejtoria e Aseteve

Drejtoria e Sportit

Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Bashkia e Shkodrës, në kuadër të mbështetjes dhe zhvillimit të arsimit, siguron mirëfunksionimin e një numri të madh institucione arsimore, mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". të Ministrave Nr. 113, datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 465, datë 06.07.2022 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe punonjësve të tjerë jo mësimorë në arsimin parauniversitar të ndryshuar" dhe V.K.M. Nr. 326, datë 31.05.2023. Pagat e punonjësve mbështetës dhe të tjerë punonjësve të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike janë përcaktuar në VKB Nr. 12, datë 20.07.2023, si dhe në VKM. Nr. 328, datë 21.05.2023, për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të punonjësve civilë dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu është e nevojshme nga vleresimi i berë që për përmirësimin e përformaces dhe rritjen e standarteve të ofrimit të shërbimit dhe permbushjes së funksioneve të ngarkuara me ligj për Drejtorinë e Arsimit të shtohet specialist teknolog dhe shofer, konkretisht për sigurimin e cilësise ushqimore dhe garantimin, monitorimin e ofrimit të shërbimit në cdo kopsht dhe çerdhe me drekë por edhe në Konvikt si dhe ne Shkollen Speciale 3 Dhjetori, si dhe per mbulimin e monitorimit të shërbimev edhe nevojave në të 51 kopshtet e Bashkisë Shkodër dhe Njësive Administrative .Fondi i parashikuar do të mbulojë shpenzimet për paga dhe sigurime për punonjësit e angazhuar, si më poshtë.

**ii.Synimiiprojektit**

Shërbimet mbështetëse të rojes dhe higjienës në institucionet e arsimit janë funksionale në shkollat e qytetit dhe në njësitë administrative.

**iii.Aktivitetetkryesoretëprojektit**

- Përshkrimi i detyrave të punës dhe sistemit të raportimit.
- Lidhja e kontratave të punës.
- Trajnimi dhe udhëzimi i personelit mbështetës, lidhur me punën.
- Raportimi dhe monitorimi i shërbimit.
- Kryerja e pagesave sipas listës së prezencës dhe punës së kryer.

**b)Rezultatetqeprisni**

- Për institucionet arsimore të arsimit të sigurojmë shërbime sa më cilësore.
- 
- Punonjësit mbështetës janë të angazhuar për kryerjen e shërbimeve mbështetëse në institucionet e arsimit.

| **c)Aktorëtemundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi mbështetës dhe ai drejtues | Bashkia e Shkodrës |

**e)Shpenzimet e llogaritura**

| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | Totali (mijëlekë) | Ngakjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Mbështetja stafi I drejtorisë (paga/sigurime shoqërore | **1,045** | 902 | 143 | | | |
| | **Shuma** | **1,045** | **902** | **143** | | | |

| **f)Periudha e zbatimit** | **g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Gjate vitit 2025 | Bashkia Shkodër.<br><br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër |

| | **P.AI141.Q3.O1.A1.**<br>Mbështetja e personelit të çerdheve (Paga dhe sigurime shoqërore) (shtesë) | **Programi AI141:** Arsimi |
|---|---|---|

**a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i.Situata**

Drejtoria e Arsimit administron çerdhet publike në territorin e bashkisë së Shkodrës. Aktualisht kjo drejtori mbështet me paga personelin e 7 Çerdheve.

Duke ju referuar regjistrimeve të deri tanishme për vitin 2024-2025 numri i fëmijëve që përfitojnë nga ky shërbim është rreth260 fëmijë të grupmoshës 0-3 vjeçnë çerdhe(117femra).

Numri i përgjithshëm i punonjësve për çerdhet është 54 punonjës. Shërbimi në çerdhe kryhet me 4 përgjegjëse,43 kujdestare dhe 7 personel shërbimi (kuzhiniere,ndihmës kuzhiniere).

Për tiu pergjigjur nevojave te qytetarëve, për të garantuar standartin në cilësinë e ofrimit të shërbimeve neper cerdhe si dhe për të respektuar përcaktimet ligjore në këtë fushë,e konsiderojme të domosdoshme shtimin e strukturës me 1 punonjes administrate te dedikuar per cerdhet.

Llogaritja e pagave behet mbi bazën VKB Nr. 55 datë 30.09.2024 "Për miratimin e strukturës së nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar,

- VKM nr. 425, datë 26.06.2024 Për miratimin e struktures dhe dhe te nivelit te pagave te punonjesve mesimore dhe te tjetre jo mesimire ne institucionet arsimore dhe institucionet plotesuese te sistemit arsimor parauniversitar",
- VKM Nr.113, datë 01.03.2023, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi,
- VKB Nr. 54.datë 30.09.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunesve civile dhe punonjësve administrative të Bashkise Shkoder dhe institucioneve të varsisë",
- VKB Nr. 76, datë 19/12/2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër".i ndryshuar

**ii.Synimiiprojektit**

Ofrimi i shërbimit në çerdhet për fëmijët e familjeve në Shkodër.

Vlerësim i nevojave aktuale për shtimin e shërbimit për fëmijët në çerdhe.

Përmirësimi shërbimit në çerdhe për fëmijët e familjeve në Shkodër.

**iii. Aktivitetetkryesoretëprojektit**

- Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim në çerdhe.
- Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit.
- Monitorim dhe raportimi mujor i aktivitetit për realizimin e projektit.

**b)Rezultatetqëprisni**

- Realizimi i të gjitha shërbimeve për krijimin e kushteve të përshtatshme në të gjitha çerdhet. Rritja e numrit të fëmijëve që frekuentojnë çerdhet.
- Fëmijët në të gjitha çerdhet në Bashkinë e Shkodrës të kenë kushte sa më të favorshme për qëndrimin e tyre.

| **c) Aktorëtemundshëm** | **d)Kontributetemundshem në projekt** |
|---|---|
| Fëmijët që frekuentojnë çerdhet në Bashkinë e Shkodrës .<br>Familjetefëmijëve që frekuentojnë çerdhet<br>Komuniteti i zonës | BashkiaShkodër |

**e)Shpenzimetellogaritura**(për çdo aktivitet tëmësipërm(pikaiii)

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | Totali (mijëlekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 Paga dhe sigurime për punonjësin Drejtor Cerdhe | **1,132** | 977 | 155 | | | |
| **Shuma** | **1,132** | 977 | 155 | | | |

| **f)Periudha e zbatimit**<br>Gjate vitit 2025 | **g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Bashkia Shkodër.<br><br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër |
|---|---|

## P.AF141.Q1.O2.A2 Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit "28 Nëntori", Shkodër

**01. Personat e Kontaktit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i propozuesit te projektit** | **Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike** | **Firma e propozuesit te Projektit** | |
| **Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit** | **dpmop@bashkiashkoder.gov.al** | | |
| **Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori** | **Bashkia Shkodër** | **Vendodhja e Projektit** | **Shkodër** |

**02. Identifikimi i Idesë se Investimit**

| | |
|---|---|
| **Projekt Idea** | Ndërtim i ambienteve sportive të gjimnazit "28 Nëntori", Shkodër |
| **Problemet për tu adresuar** | Shkolla 28 Nëntori është një nga shkollat e Mesme të para të Qytetit të Shkodrës me një traditë edukimi të gjatë ku breza të shumtë kanë kryer me sukses shkollimin. Në këtë shkollë aktualisht frekuentojnë mësimin 612 nxënës duke e bërë një nga shkollat e mesme më të frekuentuara të qytetit.<br>Shkolla ndodhet në qëndër të qytetit dhe ka një infrastrukturë të mirë sa i përket godinës dhe mjediseve të jashtme. Ndërkohë sa i përket palestrës së shkollës ajo e ka humbur funksionin e saj për shkak të amortizimit në vite.<br>Për kryerjen e aktiviteteve rekreacionale dhe sportive është me shumë vlerë që kjo shkollë duke marrë parasysh edhe numrin e lartë të nxënësve të këtë edhe mjedise të brendshme, të mbyllura në të cilat mund të zhvillohen këto aktivitete. |
| **Emri i Programit** | AF141 Kultura, Sporti, Argëtim |
| **Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen** | Ky mjedis i rikualifikuar përvec përdorimit nga nxënësit e shkollës gjatë orarit të mësimit mund të shërbejë edhe për aktivitete jashtëshkollore rekreative të cilat afrojnë komunitetin me Shkollën dhe me aktivitetet sportive<br>E gjithë sipërfaqja e brendshme e ish – palestrës ka nevojë për rikonstruksion dhe rikonceptim të saj në një mjedis multifunksional ku mund të zhvillohen aktivtetet sportive. Në këtë mjedis mungojnë paisjet dhe infrastruktura e lehtë për të bërë të mundur zhvillimin e orëve mësimore sportive prandaj propozohet realizimi i këtij projekti i cili do të mundësojë zhvillimin e këtyre aktiviteteve brend godinës.<br><br>Përmes realizimit të këtij projekti synohet kompletimi i palestrës me elementët e nevojshëm për të kryer aktivitetet të mbyllura sportive, si tavolina ping pongu, hapsira dhe element për zhvillimin e aktiviteteve të gjimnastikës, etj, paisje që shërbejnë për zhvillimin e orëve sportive. |

**0.3. Kostot e Projektit te Investimit**

| **Ndërtimi i Ambjenteve Sportive Shkolla "28 Nëntori"** | | | |
|---|---|---|---|
| **Kostot e Projektit te Investimit/lek** | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |
| **Kosto e zbatimit** | **16,754,578** | 5,026,374 | 11,728,204 |
| **Kosto supervizim** | **273,109** | 273,109 | |
| **Kosto kolaudim** | **31,653** | 31,653 | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **17,059,340** | **5,331,136** | **11,728,204** |
| | | | |
| **Kostot e Projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS / lek** | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kosto e zbatimit | **12,565,933** | 2,513,187 | 10,052,746 |
| Kosto supervizim | | | |
| Kosto kolaudim | | | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | 12,565,933 | **2,513,187** | **10,052,746** |
| | | | |
| | | | |
| **Kostot e Projektit te Investimit / lek - Financim nga NJQV** | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |
| **Kosto e zbatimit** | **4,188,645** | 2,513,187 | 1,675,458 |
| **Kosto supervizim** | **273,109** | 273,109 | |
| **Kosto kolaudim** | **31,653** | 31,653 | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **4,493,407** | **2,817,949** | **1,675,458** |

**04.** Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit<br>*Statusi i Projektit Idesë* |
|---|---|---|---|---|
| **Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)** | | | | Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej |
| **Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit**<br><br>**Investimi do të realizohet:**<br>faza parë në vitin 2025 në shumën **5,331,136 lekë**<br>faza dytë në vitin 2026 në shumën **11,728,204** lekë | | | | |
| | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë |









## P.AF141.Q1.O2.A3 Ndërtim i ambienteve sportive të Shkollës "Tring Smajli"

01. Personat e Kontaktit

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i propozuesit te projektit** | **Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike** | **Firma e propozuesit te Projektit** | |
| **Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit** | **dpmop@bashkiashkoder.gov.al** | | |
| **Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori** | **Bashkia Shkodër** | **Vendodhja e Projektit** | **Shkodër** |

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

| | |
|---|---|
| **Projekt Idea** | Ndërtim i ambjenteve Sportive të Shkollës "Tring Smajli" |
| **Problemet për tu adresuar** | Shkolla "Tring Smajli" ka një sipërfaqe të sheshit prej 7000 m2 dhe aktualisht nuk mund të shfrytëzohet për aktivitete sportive për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. E gjithë sipërfaqja e oborrit është e shtruar me beton duke mos ofruar kushte të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive shkollore dhe jashtë shkollore. Në këtë oborr të shkollës mungojnë aksesorët për zhvillimin e aktiviteteve sportive duke e bërë të pamundur dhe të pashfrytëzueshme të gjithë oborrin. |
| **Emri i Programit** | AF141 Kultura, Sporti, Argëtim |
| **Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen** | Rikualifikimi i ambienteve sportive në Shkollën "Tring Smajli" do të jetë në funksion të nxënësve por edhe të të rinjve të lagjes nr. 3 duke krijuar një mjedis të këndshëm në të cilin zhvillohen aktivitete sportive. Rimodelimi i të gjithë sheshit, si para ndërtesës, ashtu edhe prapa, e kthen këtë shësh në një hapësirë multifunksionale sportive dhe rekreative. Hapësirat sportive dhe rekreative do të mund të përdoren si nga nxënësit dhe mësuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti në territorin administrativ ku ndodhen shkolla<br>Përmes realizimit të këtij projekti synohet ndërtimi i 1 fushe të basketbollit 1 fushe për volejboll si dhe një fushe kalceto me përmasa 30m * 17m me mbulesë. Fushat e basketbollit dhe volejbollit do të jenë të kompletuara me të gjitha aksesorët sipas standardeve më të mira duke shtruar edhe terrenet me material rezinë që e bën më të sigurtë zhvillimin e aktivitetit sportiv. Gjithashtu do të realizohet edhe një pistë vrapimi me tartan. |

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

| **Tring Smajli Fushe Sportive** | | | |
|---|---|---|---|
| **Kostot e Projektit te Investimit/lek** | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |
| **Kosto e zbatimit** | **53,376,813** | 16,013,044 | 37,363,769 |
| **Kosto supervizim** | **1,121,072** | 1,121,072 | |
| **Kosto kolaudim** | **48,000** | 48,000 | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **54,545,885** | **17,182,116** | **37,363,769** |
| | | | |
| **Kostot e Projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS / lek** | | | |
| | Totali | Viti 2025 | Viti 2026 |
| **Kosto e zbatimit** | **40,032,610** | 8,006,522 | 32,026,088 |
| **Kosto supervizim** | | | |
| **Kosto kolaudim** | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **40,032,610** | **8,006,522** | **32,026,088** |
| | | | |
| | | | |

| **Kostot e Projektit te Investimit / lek - Financim nga NJQV** | | | |
|---|---|---|---|
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |
| **Kosto e zbatimit** | **13,344,203** | 8,006,522 | 5,337,681 |
| **Kosto supervizim** | **1,121,072** | 1,121,072 | |
| **Kosto kolaudim** | **48,000** | 48,000 | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **14,513,275** | **9,175,594** | **5,337,681** |

**04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë**

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit<br>*Statusi i Projektit Idesë* |
|---|---|---|---|---|
| **Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)** | | | | Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej |
| **Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka)**<br>**Institucioni Likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit**<br><br>**Investimi do të realizohet:**<br>faza parë në vitin 2025 në shumën **17,182,116** **lekë**<br>faza dytë në vitin 2026 në shumën **37,363,769 lekë** | | | | |
| | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë |
| | | | | |





## P.AI141.Q1.O3.A7. Rikonstruksion “Kopshti Ton Alimhilli”

01. Personat e Kontaktit

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i propozuesit te projektit** | **Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike** | **Firma e propozuesit te Projektit** | |
| **Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit** | **dpmop@bashkiashkoder.gov.al** | | |
| **Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori** | **Bashkia Shkodër** | **Vendodhja e Projektit** | **Shkodër** |

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

| | |
|---|---|
| **Projekt Idea** | Rikonstruksion “Kopshti Ton Alimhilli” |
| **Problemet për tu adresuar** | Gjendja aktuale e ndërtesës së kopshtit "Ton Alimhilli" tregon nevojën urgjente për një rikonstruksion të plotë dhe modernizim, pasi infrastruktura e saj nuk përmbush kërkesat bashkëkohore për sigurinë, komoditetin dhe efikasitetin energjetik.<br>Mungesa e Hapësirave të Përshtatshme për Fëmijët dhe Prindërit<br>Problematika me Ambientet e Pushimit dhe Komoditetin e Fëmijëve<br>Ajrimi dhe ndriçimi<br>Sistemi i Ngrohjes dhe Ftohjes |
| **Emri i Programit** | AI141 Arsimi |
| **Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen** | Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe të sigurta për fëmijët, për të garantuar që ata mund të frekuentojnë kopshtin në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme. Ky rikonstruksion i plotë është një mundësi për të modernizuar dhe përmirësuar infrastrukturën e kopshtit, duke ofruar një ambient të sigurt, komod dhe efikas energjetikisht, që do të kontribuoni në zhvillimin e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për prindërit dhe stafin. Kjo do të ishte një investim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve dhe komunitetit.<br>Rikonstruksioni do të synojë të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijëve në aspekte të ndryshme, duke përfshirë edukimin, aktivitetet fizike dhe ato rekreative.<br>Krijimi i hapësirave të përshtatshme për aktivitete të ndryshme që stimulojnë zhvillimin e shkathtësive sociale, kreative dhe fizike të fëmijëve.<br>Ky projekt rikonstruksioni do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të edukimit për fëmijët, duke i ofruar atyre një ambient të sigurt, të ngrohtë dhe të përshtatshëm për zhvillimin e plotë të potencialeve të tyre.<br>Rikonstruksioni do të përfshijë mjediset e brendshme dhe të jashtme të këtij kopshti sipas standardeve të ndërtimit të objekteve të tilla duke e rikonceptuar si nje mjedis multifunksional e rekreativ që nxit zhvillimin e fëmijëve. |

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

| **Rikonstruksion “Kopshti Ton Alimhilli”** | | | |
|---|---|---|---|
| **Kostot e Projektit te Investimit/lek** | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |
| **Kosto e zbatimit** | **45,996,241** | 13,798,872 | 32,197,369 |
| **Kosto supervizim** | **665,403** | 665,403 | |
| **Kosto kolaudim** | **47,198** | 47,198 | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **46,708,842** | **14,511,473** | **32,197,369** |
| | | | |
| **Kostot e Projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS / lek** | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |
| **Kosto e zbatimit** | **34,497,181** | 6,899,436 | 27,597,745 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kosto supervizim** | | | |
| **Kosto kolaudim** | | | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **34,497,181** | **6,899,436** | **27,597,745** |
| | | | |
| | | | |

| **Kostot e Projektit te Investimit / lek - Financim nga NJQV** | | | |
|---|---|---|---|
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** |
| **Kosto e zbatimit** | **11,499,060** | 6,899,436 | 4,599,624 |
| **Kosto supervizim** | **665,403** | 665,403 | |
| **Kosto kolaudim** | **47,198** | 47,198 | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **12,211,661** | **7,612,037** | **4,599,624** |

**04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë**

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit<br>*Statusi i Projektit Idesë* |
|---|---|---|---|---|
| **Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)** | | | | Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej |
| **Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka)**<br>**Institucioni Likuidues: Drejtoria e Arsimit**<br><br>**Investimi do të realizohet:**<br>faza parë në vitin 2025 në shumën **14,511,473 lekë**<br>faza dyte në vitin 2026 në shumën **32,197,369 lekë** | | | | |
| | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë |
| | | | | |




elledi







## P.AI141.Q1.O3.A8. Rikonstruksion dhe ndërtim palestre "Shkolla e hapur "Ismail Qemali"

**01. Personat e Kontaktit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i propozuesit te projektit** | **Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike** | **Firma e propozuesit te Projektit** | |
| **Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit** | **dpmop@bashkiashkoder.gov.al** | | |
| **Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori** | **Bashkia Shkodër** | **Vendodhja e Projektit** | **Shkodër** |

**02. Identifikimi i Idesë se Investimit**

| | |
|---|---|
| **Projekt Idea** | Shkolla e Hapur "Ismail Qemali" |
| **Problemet për tu adresuar** | Muret dhe suvatimet janë të amortizuara dhe kërkojnë riparime.<br>Dyert dhe dritaret janë të dëmtuara dhe mund të mos ofrojnë efikasitetin energjetik të kërkuar. Ambjentet e përbashkëta janë të paaftë të përmbushin kërkesat për zhvillimin e aktiviteteve arsimore dhe rekreative.<br>Ndërtesa nuk i përmbush standardet e sigurisë dhe komoditetit për arsimin 9 vjeçar, që mund të ndikojë negativisht në përvojën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Klasat dhe ambjentet e përbashkëta kërkojnë rinovim për të krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve të tjera.<br>Nevoja për ndërhyrje të sistemeve të sinjalistikës dhe Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ) për të krijuar një sistem funksional dhe të sigurt.<br>Objekti nuk eshte i përshtatshme për PAK, duke përfshirë rampa hyrëse që janë jashtë standardeve. Tualetet janë të dëmtuara dhe nuk përmbushin kërkesat për përdorim nga PAK.<br>Rrjeti elektrik ka nevojë për rinovim për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas. Godina është e paisur me Kaldajë me naftë dhe duhet integruar me projektin e rikualiikimit. |
| **Emri i Programit** | AI 141 Arsimi |
| **Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen** | Ndërhyrje të sistemeve të sinjalistikës dhe Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ) për të krijuar një sistem funksional dhe të sigurt.<br>Ndërhyrje do të ketë edhe në rrjetet elektrike duke realizuar rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm të ndricimit. Rrjeti hidraulik gjithashtu do të ketë instalime të reja. krijimin e një hapësire funksionale dhe tërheqëse, që jo vetëm përmirëson mjedisin arsimor, por edhe kontribuon në forcimin e lidhjeve sociale dhe komunitare.<br>Krijimi i klasave moderne dhe fleksibile që mund të përshtaten për metoda mësimdhënieje të ndryshme (grupore, individi, aktivitete praktike, etj.).<br>Sigurimi i kushteve për mësim të përshtatshëm, me hapësira të ajrosura dhe të ndriçuara mirë, që ndihmojnë në përqëndrimin e nxënësve dhe rritin produktivitetin e mësimit.<br>Përdorimi i materialeve moderne dhe efikase për ngrohje dhe ftohje, për të garantuar një ambient komod gjatë gjithë vitit.<br>Ndërtimi i palestrës së mbyllur dhe mjediseve të laboratorëve. |

**0.3. Kostot e Projektit te Investimit**

| **Shkolla e hapur "Ismail Qemali"** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kostot e Projektit te Investimit / lek** | | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** | **Viti 2027** |
| **Kosto e zbatimit** | **299,806,216** | 89,941,864 | 139,238,178 | 70,626,174 |
| **Kosto supervizim** | **1,766,657** | 1,766,657 | | |
| **Kosto kolaudim** | **113,942** | 113,942 | | |
| **Kosto Totale e Projektit- 000/lekë** | **301,686,815** | **91,822,463** | **139,238,178** | **70,626,174** |
| | | | | |

| Kostot e Projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS / lek | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** | **Viti 2027** |
| **Kosto e zbatimit** | **224,854,662** | 44,970,932 | 109,257,556 | 70,626,174 |
| **Kosto supervizim** | | | | |
| **Kosto kolaudim** | | | | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **224,854,662** | **44,970,932** | **109,257,556** | **70,626,174** |
| | | | | |
| | | | | |
| **Kostot e Projektit te Investimit / lek - Financim nga NJQV** | | | | |
| | **Totali** | **Viti 2025** | **Viti 2026** | |
| **Kosto e zbatimit** | **74,951,554** | 44,970,932 | 29,980,622 | |
| **Kosto supervizim** | **1,766,657** | 1,766,657 | | |
| **Kosto kolaudim** | **113,942** | 113,942 | | |
| **Kosto Totale e Projektit- lekë** | **76,832,153** | **46,851,531** | **29,980,622** | |

**04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë**

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit<br>***Statusi i Projektit Idesë*** |
|---|---|---|---|---|
| **Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)** | | | | Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej |
| **Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni Likuidues: Drejtoria e Arsimit**<br><br>**Investimi do të realizohet:**<br>faza e parë në vitin 2025 në shumën **91,822,463 lekë**<br>faza e dytë në vitin 2026 në shumën **139,238,178 lekë**<br>faza e tretë në vitin 2027 në shumën **70,626,174 lekë** | | | | |
| | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë |
| | | | | |








**VISUALIZATION**
SHKOLLA ISMAIL QEMALI
© 2024 OPPENHEIM ARCHITECTURE

| | P.AE141.Q1.O1.A3<br>Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës ( Shtesë ) | **Programi AE141**: Shërbimet Publike Vendore |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia e Shkodrës është përgjëgjëse në rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Gjatësia totale e rrjetit rrugor që mirëmbahet në qytet është 202.3 km.
Ndërmarrja do të kryej një numër aktivitetesh (pune dhe shërbimi) me qëllim që të arrijë nivelin e kërkuar të shërbimit për përdoruesit e rrugës në të gjithë rrjetin rrugor në qytet. Në mënyrë specifike, punimet e mirëmbajtjes që do të kryhen konsistojnë në:
Ne funksion te mirembajtjes se infrastruktures me punojesit tane, duke patur ne konsiderate te gjitha keto procese pune qe kryejme ne funksion te detyrave tona , jemi ne kete situate;

a- Planifikimi dhe organizimi i puneve, nga dita ne dite vjen duke u permisuar ne Ndermarrjen tone.
b- Deri ne kete faze kemi kaluar me veshtirsi , ne funksion te mbulimit me vegla pune, te punonjesve tane.
c- Ne keto kushte te kerkeses sone te llogarise per rritjen e efektshmerise ne pune ,kerkojme plotesimim me pajisje dhe vegla pune, pajisje dhe mjete per sigurin ne pune , Investim qe e kerkojme si shtese buxheti

**ii. Synimi i projektit**

Krijimi kushteve optimale te punonjesve tane, me pajisje dhevegla pune per realizimim e detyrave .
Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve ne volume me te medha se deri tani
Rritja e eficences për punimet në qytet, si dhe ndërhyrje më efikase dhe precize për riparimin e rrjetit të infrastrukturës.
Nisur nga nevojat dhe natyra e punës së NSHPP, nevojitet të blihet një mjet i tipit minieskavator. Ky mjet nevojitet për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes kryesisht në qytet, ku mundësia e lëvizshmërisë dhe aksesit është e kufizuar.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1-Planifikimi i sakte i pajisjeve dhe veglave te punes per punonjesit.
2-Grafikimim me pajisje dhe vegla pune duke krijuar nje organizim pune me tre grupe pune.
3-Hartimi i dokumentacionit perkates per poceduren e prokurimit.

**b) Rezultatet që prisni**

- Përmirësimi i infrastruktures rrugore ne siperfaqe me te medha.
- Krijimi I kushteve te punes per te marre eficencen e plote te punonjesve ne mirembajtjen e rrugeve dhe trotuareve
- Rritja e eficencës në punimet e mirëmbajtjes në infrastrukturën rrugore

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshëm në projekt** |
|---|---|
| Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike<br>Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve dhe Mirembajtjes | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 (shtese)** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.2 | Blerje makineri per mirembajtjen e infrastruktures | **4,500** | | | | | 4,500 |
| A.3 | Blerje pajisje pune. | **2,600** | | | | | 2,600 |
| | **Shuma** | **7,100** | | | | | **7,100** |

| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Gjatë vitit 2025 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mirembajtjes se Infrastruktures<br><br>**Institucioni likuidues:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| | **P.AE141.Q1.O1.A4**<br>Mirëmbajtje, rehabilitim i skemës ujitëse ( shtesë) | **Programi AE141:** Shërbimet Publike Vendore |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër me nje vemendje te shtuar , po ndërhynë për përmirësimin e rrjetit ujitës duke mirëmbajtur ate. Prioritet mbetet rritja e siperfaqes ujitese per fermeret.
Aktualisht kerkesat jane shume te medha , duke marre ne konsiderate gjendjen e trasheguar ne kanalet ujitese.
Kemi siperfaqe te tera toke te pamundura te futen ne sistemin vadites.
Situate kjo e njejte pothuajse ne te gjitha Njesite Administrative.
Sa me i madh buxheti per mirembajtjen ne kanale ujitese aq me rezutativ eshte sistemi i kullim-ujitjes.
Per kete eshte e nevojshme te planifikohen vlera shtese ne buxhet , gjithnje ne rritje per te kaluar keto situata jo te mira ne sistem kullim-ujitje.

**ii. Synimi i projektit**

Menaxhimi i tokës bujqësore duke u futur ne sistemin vadites , rritja e rendimenteve në bujqësi,përmirësimi i standartit të jetesës së fermerëve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Ndërhyrje në sistemin ujitës në zonat me më prioritet duke kryer rehabilitim dhe vendosje tombinash në segmentet e dëmtuara.
Përfundimi i projektit teknik me rishikimin e preventivit dhe të volumeve të punës dhe të analizës.
Përpilimi i dokumentacionit të nevojshëm per nderhyrje
Fillimi i punimeve si dhe përfundimi i tyre në segmentet e përcaktuara për rehabilitim
Blerje dhe vendosje tombinosh

**b) Rezultatet që prisni**

Mirëmbajtje e segmenteve më të dëmtuara që kanë nevoja për ndërhyrje emergjente,të kanaleve ujitëse
- Përmirësimi rrjetit ujitës
- Rritja e sip. toke bujqesore e ujitur, ku konkretisht , sipas nderhyrjeve kemi keto rezulate:
  1- Nderhyrja ne Nj.A Guri Zi , permison ne sistemi ujites nje siperfaqe prej 500 ha.
  2- Nderhyrja ne Nj.A Postrib, permison ne sistemin ujites nje siperfaqe prej 250 ha.
  3- Nderhyrja ne Nj.A Rrethina, permison ne sistemin ujites nje siperfaqe prej 130 ha.
  4- Nderhyrja ne Nj.A Berdic , permison ne sistemin ujites nje siperfaqe prej 200 ha.
- Rritja e numrit të familjeve fermere përfituese
- Rritja e sipërfaqes së mbuluar me ujitje

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshëm në projekt |
|---|---|
| Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike<br>Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve dhe Mirembajtjes | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 (shtese) | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.2 | Mirëmbajtje e skemës ujitëse Gur I zi, Nj.A Guri Zi | **7,000** | | | 7,000 | | |
| A.3 | Mirëmbajtje e skemës ujitëse Boks-Dragoc-Kullaj, Nj.A Postrib | **7,000** | | | 7,000 | | |
| A.4 | Mirëmbajtje e skemës ujitëse Bardhaj - Bleran, Nj.A Rrethina | **6,650** | | | 6,650 | | |
| A.5 | Mirëmbajtje e skemës ujitëse Berdice, Nj.A Berdice | **7,200** | | | 7,200 | | |
| | **Shuma** | **27,850** | | | **27,850** | | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| Gjatë vitit 2025 | Drejtoria e Mirembajtjes se Infrastruktures<br><br>**Institucioni likuidues:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike |

| | **P.AE141.Q1.O1.A5**<br>Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma | **Programi AE141:** Shërbimet Publike Vendore |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër në zbatim të :
Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", Neni 27
Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit. Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:
1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronës të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.
5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Të ligjit nr. 24/2017 " Për administrimin e ujitjes dhe kullimit",
Neni 15 Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Bashkive:
1. Bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastruk-turën e ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi, që plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin kripëzimit dhe toksifikimit. 2. Bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastruk-turën e ujitjes, në mënyrë të tillë që ç fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar. 3. Bashkia, brenda zonës së vet të shërbimit: a) pastron dh mirëmban kanalet kulluese dhe ujitëse; b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe të kullim c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja n zonat e banuara; ç) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe, kur është e nevojshme, krye ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre; d) merr në shqyrtim pasoj e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullim ose dëmet në të; dh) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet; e) përmbush detyra në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore; ë) monitoron sasinë e ujit që përd gjatë një viti. 4. Bashkia bashkëpunon për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dh rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me drejtorinë përkatëse të ujitjes dhe të kullimit, në rastet kur kjo fundit administron infrastrukturën kryesore në këto sisteme.
Neni 16 Burimet e të ardhurave.
Burimet e të ardhurave për bashkinë, për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, përbëhen nga: a) tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit; b) tarifa shërbimit të ujitjes; c) fonde nga Buxheti i Shtetit, që u transferohen bashkive, sipas përcaktimeve të ligjit vjetor Buxhetit të Shtetit apo legjislacionit të financave vendore; ç) burime të tjera nga të ardhurat e veta; d) donacion grante dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
Neni 17 Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës
1. Bashkia mbledh tarifën vjetore të mirë-mbajtjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të shërbimit ujitjes. Afati i pagesës së kësaj tarife është brenda datës 31 janar të çdo viti. 2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes njoftohet, me shkrim, zotëruesit të tokës dhe përllogaritet duke iu referuar madhësisë së sipërfaqes së saj, n përpjesëtim me madhësinë e përgjithshme të zonës së shërbimit të ujitjes. 3. Kjo tarifë përfshin shpenzimet mirëmbajtjes vjetore të sistemit të ujitjes, shpenzimet për përgatitjen e këtij sistemi për stinën e ardhshme të ujitj dhe koston e pastrimit të kanaleve kulluese.
Neni 18 Tarifa e shërbimit të ujitjes
1. Bashkia vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo fermeri. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdor për çdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe. 3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për një përllogaritet duke iu referuar shpenzimeve për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitj përfshirë çdo shpenzim të bërë për furnizimin e një rezerve të tillë ujore.
Neni19 Miratimi i tarifave.
Me qëllim përmirësimin e shërbimit të ujitjes në zonat ku ofrohet ky shërbim, dhe zgjerimin e hartës së mbulimit me këtë shërbim, është përllogaritur kostoja e tarifës së këtij shërbimi referuar në shpenzimeve të kryera për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, duke përfshijë çdo shpenzim të bërë për furnizimin me ujë.
Për vjeljen e tarifës së ujitjes do jenë të punësuar 10 punonjës sezonal për një periudhe 5 mujore, të cilët do kenë si detyrë gjithashtu menaxhimin e ujit për ujitje sipas kërkesave të fermerëve.

**ii. Synimi i projektit**

Planifikimi i nevojave për ujë për ujitje në menyrë që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

-Kërkesat për nevojat dhe siperfaqet që do ujiten
-Miratimi i kërkesave
- Procesi i furnizimit me ujë për ujitje sipas një grafiku të përcaktuar
-Menaxhimi i ujitjes me anë të punonjësve sezonal.

**b) Rezultatet që prisni**

- Furnizimi me ujë për ujitje për çdo fermer që e kërkon në kohë dhe në sasinë e kërkuar.
- Menaxhim efikas i rrjetit dhe sasise se ujit per ujitje.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshëm në projekt** |
|---|---|
| NSHPP<br>Sektori I ujitjes dhe kullimit<br>Drejtoria e Bujqesise, zhvillimit rural dhe trajtimit AMTP | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Paga sigurime per punonjes me kontrate | **3,372** | 2,909 | 463 | | | |
| | **Shuma** | **3,372** | **2,909** | **463** | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>**Viti 2025** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br><br>Sektori Ujitjes dhe Kullimit<br><br>**Institucioni likuidues:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike |

| | P.AE141.Q2.O1.A4<br>A Lujmë Bashkë? | **Programi AE141:** Shërbimet Publike Vendore |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Lulishtet dhe hapsirat publike në lagje dhe në zonat të Bashkisë Shkodër kanë nevojë për një transformim radikal sa i përket krijimit të kendeve për fëmijë me lojra dhe hapsira rekreative. Aktualisht lulishtet e qytetit kanë kënde lojrash të cilat janë të amortizuara dhe kanë nevojë për ndëryrje dhe krijim të kushteve të favorshme për kalimin e kohës së lirë të fëmijëve. Gjendja aktuale e këndeve të lojërave në territorin e bashkisë është kryesisht e amortizuar dhe e trashëguar nga vite të mëparshme, duke bërë të domosdoshme një ndërhyrje të menjëhershme dhe të thellë për ndërtimin dhe rikualifikimin e këtyre hapësirave.

**ii. Synimi i projektit**

Përmes këtij propozimi, synohet zbatimi i projektit "A Lujmë Bashkë?", i cili ka si qëllim transformimin rrënjësor të mënyrës së kalimit të kohës së lirë për fëmijët e Bashkisë Shkodër. Loja është një element thelbësor në procesin e zhvillimit të fëmijëve, duke kontribuar në përmirësimin e aftësive fizike, emocionale dhe njohëse të tyre. Përmes lojës, fëmijët shprehin krijimtarinë, sfidojnë veten dhe ndërtojnë marrëdhënie sociale të shëndetshme.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Krijimi dhe rehabilitimi i këndeve të lojërave në lagje, parqe dhe institucionet arsimore publike;
2. Sigurimi i aksesit të barabartë për të gjithë fëmijët në ambiente cilësore dhe të sigurta për lojë dhe zhvillim;

**b) Rezultatet që prisni**

1. Nxitja e aktivitetit fizik dhe socializimit tek fëmijët;
2. Përmirësimi i cilësisë së jetesës në komunitet përmes infrastrukturës rekreative.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshëm në projekt** |
|---|---|
| Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike<br>Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve dhe Mirembajtjes | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Siguri me | Operat ive | Transf erime | Kapital e |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Kosto Projektimi | **1,519** | | | | | 1,519 |
| A.2 | Kosto e zbatimit | **30,000** | | | | | 30,000 |
| A.3 | Kosto supervizim | **715** | | | | | 715 |
| A.4 | Kosto kolaudim | **40** | | | | | 40 |
| | **Shuma** | **32,274** | | | | | **32,274** |

| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Viti 2025 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mirembajtjes se Infrastruktures<br><br>**Institucioni likuidues:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike |
|---|---|

| | P.AE141.Q3.O1.A3:<br>Lëvizshmëria dhe sinjalistika (Shtesë) | **Programi AE141:** Shërbimet Publike Vendore |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

a. Lëvizshmëria

**Situata e vlerësuar:**

